Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 6 (38). QERSHOR 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

Big Market
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

TRADITË

Ku janë urat e Dibrës së Madhe?

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 7

INTERVISTË

Të vlerësohen artistët emigrantë

Me artistin **ESAT RUKA** - FAQE 13

KULTURË

Zall - Dardha, djepi i artistëve

Nga: **NAIM PLAKU** - FAQE 4

VENDLINDJA

Katër Grykët, vlerë e etnografisë

Nga: **MEVLUD BUCI** - FAQE 6

Inaugurohet shtatorja e Skënderbeut

Shtatorja paraqet një Skënderbe, një djalë të ri, që sapo ka mbërritur në Dibër, pasi braktisi frontin e Nishit, një Gjergj Kastriot, që po përshëndetej me vëllezërit e tij dhe po i ftonte për të nisur betejat madhore, që historia tashmë i ka gdhendur në çdo gur e mal të këtyre trojeve të lashta shqiptare. Shtatorja 3.3 metra e lartë është punuar nga skulptori Sadik Spahija dhe është derdhur në bronx në Bullgari. Ajo i është dhuruar qytetarëve të Peshkopisë nga Zaim Korsi.

SPECIALE NË FAQET 3,8,9



RRUGA E ARBËRIT

Bulqizë - Ura e Vashës, zhvillohet tenderi për 10 km e para

Ky segment, tërësisht i ri, i gjatë 10 km, do të kushtojë rreth 21.5 milionë Euro, pa TVSH. Punimet në këtë segment të Rrugës së Arbërit do të zgjasin 20 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me fituesin. I gjithë ky segment rrugor do të ketë një gjerësi prej 11 metrash (gjerësia e rrugës 7 metra dhe 2 bankina me nga 1 metra të asfaltuar)



Pamje nga segmenti i rrugës së asfaltuar Bulëizë - Ura e Çerenecit, inaguruar nga kryeministri Berisha me datë 21 qershor, 1 jave para zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. Foto: Gazmend Kërkuti (dibra.org)

LAB LABORATOR ALLIANCE
• Analiza Biokimike • Hormonale.
• Vizita dermatologjike nga Doktoreshë Monika Fida
• Trajtim me lazer
• Dermatoskopi e vetmja në të gjithë vendin.
Kujdesuni sot për shëndetin tuaj
Adresa: "Rruga Don Bosko"Pallati Gener.
Tel: (04) 22 66 300. Cel: 068 20 64 725

Më datën 18 qershor, me procedure të hapur elektronik, u zhvillua tenderi për tre lotet e segmentit të Rrugës së Arbërit nga Bulqiza te Ura e Vashës.

Posta e Rruga Arbërit


Gazetë e pavarur.
Nr. 6 (38). 1- 30 Qershor 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Naim Plaku, Agron Tufa, Xhelal Roçi, Odise Plaku, Kujtim Boriçi, Ymer Stojku etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Rexhep TORTE,
Dr. Bernard ZOTAJ
Naim PLAKU
Nefail SPAHIU
Abdurahim ASHIKU
Sakip CAMI
Moisi MURRA
Mevlud BUCI
Tefik SKERA
Marius DOBRESCU
Zaim ELEZI
Xhafer MARTINI
Ymer KETA
Neki KALOSHI
etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

RRUGA E ARBËRIT

Bulqizë - Ura e Vashës, zhvillohet tenderi për 10 km e para

Më datën 18 qershor, me procedure të hapur elektronik, u zhvillua tenderi për tre lotet e segmentit të Rrugës së Arbërit nga Bulqiza te Ura e Vashës.

Kështu, më në fund duket se po merr jetë Rruga e vërtetë e Arbërit.

Sipas dokumentave të publikuara në faqen e internetit të Agjensisë së Prokurimeve Publike, ky segment, tërësisht i ri, i gjatë 10 km, do të kushtojë rreth 21.5 milionë Euro, pa TVSH

Në këtë segment nuk janë të përfshira tuneli i Qafës së Buallit, dhe dy viadukte, njëri në Bulqizë dhe një tjetër në Zallin e Planit të Bardhë.


Punimet në këtë segment të Rrugës së Arbërit do të zgjasin 20 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me fituesin.

Loti i parë i këtij segmenti është i gjatë 3900 ml, ose afërsisht 4 km. Ky lot fillon në Bulqizë, aty ku përfundon segmenti aktual i Rrugës së Arbërit dhe vazhdon deri në Qafë Buall, aty ku do të ndërtohet edhe tuneli 850 metra. Ky lot do të kushtojë rreth 1 miliardë lekë, pa TVSH, ose përafërsisht 8 milionë Euro. Rruga do të kalojë në zonën e Fushë Bulqizë, relativisht në terren fushor. Në ndërprerje me rrugën ekzistuese që lidh Bulqizën e vjetër dhe Bulqizën e re është parashikuar kryqëzim në disnivel, por që nuk është përfshirë në këtë lot.

Segmenti i dytë fillon në dalje të Qafës së Buallit dhe vazhdon në anën e djathtë të luginës së Planit të Bardhë. Ky segment do të jetë i gjatë rreth 3800 metra dhe po ashtu do të kushtojë përafërsisht 8 milionë Euro, pa TVSH (999 349 257 lekë).

Ky segment rrugor është tërësisht i ri dhe kalon në një terren kryesisht shkëmbor. Rruga kalon në anën e djathtë të përroit Zallit të Planit të Bardhë.

Ndërsa loti i tretë, 2600 metra, fillon pas viaduktit në fundin e Luginës së Planit të Bardhë dhe përfundon afër Urës së Vashës. Terreni që përshkon Loti 3 është malor, shumë i thyer. Rruga kalon në anën e djathtë të përroit Zalli i Planit të Bardhë dhe më pas të lumit të Matit.



- Ky segment, tërësisht i ri, i gjatë 10 km, do të kushtojë rreth 21.5 milionë Euro, pa TVSH
- Punimet në këtë segment të Rrugës së Arbërit do të zgjasin 20 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me fituesin.
- I gjithë ky segment rrugor do të ketë një gjerësi prej 11 metrash (gjerësia e rrugës 7 metra dhe 2 bankina me nga 1 metra të asfaltuar)

Ky segment do të kushtojë afërsisht 6 milionë Euro (752 656 068 lekë) pa TVSH

I gjithë ky segment rrugor do të ketë një gjerësi prej 11 metra, ku do përfshihet gjerësia e rrugës 7 metra, 2 bankina me nga 1 metra të asfaltuar, shoqëruar me kunete 1m gjërësi në gërmim dhe në mbushje me kunete tip i vogël.

Paketa kryesore e shtresave rrugore gjatë këtij segmenti të Rrugës së Arbërit është 4cm asfaltobeton, 5cm binder, 8cm konglomerat bituminoz, stabilizant 0/31,5mm, 20cm (2x10cm), Material i thyer 5/40mm, 30cm (2x15cm) ose 20cm (2x10cm), material çakull ose zhavorr, 20cm.

Mbushja e trasese eshte parashikuar me material nga kariera ose me materiale të përshtatshme të dala nga gërmimet e trasesë.


Përsa i përket zonës trofike ne Bulqizë, parashikohen masa inxhinierike si heqja e përmbajtja torfike në gjerësine e tabanit të mbushjes dhe zëvendësimin e saj me material filtrant, duke vendosur më parë gjeotekstil dhe gjeogrid. Mbi materialin e mbushjes në nivelin e terrenit ekzistues vendoset një shtresë e re gjeotekstili në të gjithë sipërfaqen e mbushjes dhe mbi të mbushja e trupit të rrugës. Janë parashikuar dhe kunderbankina.

Burime nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve bëjnë të ditur për gazetën se së shpejti do të bëhen edhe tenderi tjetër për një segment të kësaj rrugë, i cili fillon nga Tirana në drejtim të Shkallës së Tujanit.

Korresp. 'Rruga e Arbërit"

Zgjedhjet parlamentare në qarkun e Dibrës: 4 deputetë për PD, 2 për PS

Kanë përfunduar zgjedhjet parlamentare në Republikën e Shqipërisë. Qarku i Dibrës, ku përfshihen Dibra, Bulqiza dhe Mati, përfaqësohet në parlament me 6 deputetë. Votimet në këtë qark, sipas rezultateve paraprake të KQZ-së, kanë nxjerrë në vend të parë Partinë Demokratike me 48.92%, më pas Partia Socialiste me 30.18%, Lëvizjen Socialiste për Integrim me 5.27%, Partia Lëvizja e Legalitetit me 3.14%, Partia Republikane me 2.6%, Lëvizjen Për Zhvillim Kombëtar me 2.13% dhe Partia Demokristiane me 1.58%. Partitë e tjera të përfshira në garë nuk kanë mundur të marrin më shumë se 1%. Sipas këtyre rezultateve, Dibra do të përfaqësohet në parlamentin e ri shqiptar me 4 deputetë të listës së Partisë Demokratike dhe 2 të Partisë Socialiste. Ato janë për PD Jemin Gjana, Sherefedin Shehu, Bedri Hoxha dhe Selami Xhepa, ndërsa për Partinë Socialiste Sadri Abazi dhe Qemal Minxhozi.




Fushata në Dibrës u përqendrua kryesisht në infrastrukturë dhe kryesisht në Rrugën e Arbërit, ku Partia Demokratike e shfrytëzoi shumë mirë këtë detaj, duke premtuar se brenda mandatit të ardhshëm do të hapet kjo arterie rrugore, shumë e rëndësishme për këta banorë.

veprimtari

Pas rreth 566 vjetësh, nga dita kur Ai me treqind kalorës u ndal në vendlindje, në Dibër, për të mbledhur krahun dhe trurin luftarak dibran për të mësy Krujën e për të krijuar shtetin e parë të bashkuar shqiptar..., Gjergji i Gjon Kastriotit, vjen përsëri në Dibër

Inaugurohet shtatorja e Skënderbeut në Peshkopi


Foto: Bujar Karoshi

Me moton "Mirë se erdhe në vendlindje", në Peshkopi më 9 qershor 2009, në Sheshin "Elezi Isufi" të mbushur përplot me banorë dhe të ftuar, u bë përurimi i shtatores së Skenderbeut, vepër e skulptorit Sadik Spahija financuar në biznesmeni Zaim Korsi. Në këtë solemnitet përveç udhëheqësve vendorë merrnin pjesë Jozefina Topalli, kryetare e kuvendit të Shqipërisë, e cila bëri shpalosjen e shtatores, ministra dhe deputetë nga Shqipëria, Argëtim Fida, kryetar i komunës Dibra e Madhe me bashkëpunëtorë dhe shumë qytetarë nga Dibra dhe qytete tjera të Maqedonisë.

Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë, duke përshëndetur të pranishmit, theksoi se: "Ky shesh dhe kjo shtatore do të jetë shesh i Dibrës, i Shqipërisë dhe shqiptarisë. Kjo ngjarje është nga më të shënuarat përkujtimore të kësaj treve, sepse përurojnë shtatoren e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, prijësit të madh shqiptar të të gjitha kohërave, kryeushtarit, kryetrimit, kryeshtetarit më në zë që ka parë Europa në këto gjashtë shekuj.

Falendërojmë gjithashtu z. Zaim Korsi, i cili na e dhuroi këtë dhuratë të çmuar historike, duke i bërë nder të madh Dibrës së tij dhe dibranëve ku u lind dhe u edukua. Skënderbeu ky kalorës dhe mbrojtës i sovranitetit kombëtar, simbol i bashkimit të shqiptarëve drejt familjes europiane, është dhe do të mbetet gjeniu dhe thelbi i europianizimit. Në këto vite të demokracisë ne po ia kthejmë borxhin heroit tonë kombëtar, kemi hyrë në NATO dhe po bëhemi gati të hyjmë në BE. Shqipëria nga vendi më i humbur e problematik i Europës, është kthyer në vendin me ritme më të larta zhvillimi në Europë, me miliarda euro investime në autostrada, porte, aeroporte, që kanë bërë të prekim ëndrrën e parealizuar të Skënderbeut për vendosjen e Shqipërisë në familjen europiane. Sot ndjehemi më të lumtur se kurrë, sepse Dibra është vendlindja e Kastriotëve dhe me këtë përurim kemi realizuar ëndrën shumëshekullore të dibranëve, duke ua rikthyer atyre nderin dhe dinjitetin historik. Ndjehemi krenarë se po realizojmë Rrugën e Arbërit, pa të cilën ëndrra jonë europianiste do të zbehej. Dibra nëpërmjet kësaj rruge do të jenë më afër kryeqendrave të Europës, si faktorë të rëndësishëm në zhvillimet e pritshmë të vendit tonë. Siç shkruante kryeministri Turk në vitin 1916, përfundimi i luftërave në këto visë varej nga Nëntë Malet e Dibrës, sepse Dibra mbetet porta dhe zemra e Shqipërisë. Betohemi para kësaj shtatore të birit tonë, para kësaj legjende kombëtare, se kanë dështuar me turp njëherë e përgjithmonë përpjekjet për të shmangur tendencën europianiste të Dibrës e Shqipërisë.

Jozefina Topalli, në përshëndetjen e saj veç tjerash, tha se: "S'ka krenari më të madhe për komunën e Kastriotit, për Qarkun e Dibrës dhe për mbarë Shqipërinë se sa që është Skenderbeu një kolos i lirisë, një prijës i paqes, në dhjetëra libra në 15 gjuhë të huaja shkruhet për vizionin e tij, vizionin e legjendës që po bënte për Shqipërinë europiane dhe figura të tilla lindin njëherë në 500 vjet.

ZAIM KORSI: "Kjo shtatore tregon pikërisht momentin e mbërritjes së tij në Dibër, kur u drejtohet dhe bisedon me dibranët për betejat e mëdha që shqiptarët duhet të përballojnë me pushtuesit. Jam shumë i lumtur që m'u krijua mundësia për t'ia dhuruar këtë shtatore popullit tim të Dibrës".

Ne shqiptarët jemi me fat se legjënda të tilla lindin në kombin tonë.

Zaim Korsi, financuesi i shtatores tha se: "Skënderbeu, heroi ynë kombëtar në mesin e shekullit 15-të, 25 vite rresht mposhti ushtrinë e madhe e të egër të kohës së sulltanëve. Gjergj Kastriori tërë jetën dhe gjithçka pati ua kushtoi këtyre trojeve. Na bëri të njohur dhe ngriti lartë emrin e shqiptarëve. Skënderbeu është nga fshati Çidhën dhe nuk ishte rastësi që për herë të parë kur braktisi ushtrinë turke për herë të parë erdhi në Dibër dhe kalorësit që e shoqëronin ishin dibranë, dhe nuk ishte rastësi që shumicën e betejave ndaj ushtrisë pushtuese u zhvilluan në Dibër. Mbështetjen kryesore ai e kërkoi dhe e gjeti në Dibër, te gjaku i tij dhe të afërmit e tij.

Këto shtytje patriotike kanë shoqëruar ndjenjat e mia gjatë tërë jetës për të patur një shtatore të heroit tonë kombëtar, në qytetin e Peshkopisë në vendin e të parëve të tij. Dhe ajo ja ku është. E gëzofshim dhe e nderofshim për jetë. Kjo shtatore tregon pikërisht momentin e mbërritjes së tij në Dibër, kur u drejtohet dhe bisedon me dibranët për betejat e mëdha që shqiptarët duhet të përballojnë me pushtuesit. Jam shumë i lumtur që mu krijua mundësia për tia dhuruar këtë shtatore popullit tim të Dibrës.

Në rrugën e përpjekjeve për ta realizuar shtatoren ka gjetur ndihmën e shumë njerëzve ndër të cilët mund të përmend zotin Sadik Spahija, skulptorin e talentuar dhe dekanin e Arteve figurative, Z. Xhelil Rufati, skulptorin nga Gostivari që ndihmoi për derdhjen ne bronz të kësaj shtatoreje në Bullgari, Aqif Ademin, regjisorin nga Maqellara, i cili në çdo kohë më ka qëndruar pranë për realizimin e kësaj shtatore.

Z. Naim Plaku, mësuesin dhe shkrimtarin i cili më ka ndenjur pranë kur po punohej në studio. Esat Manjanin, biznesmen i cili dhuroi gurin si bazament ku është vendosur shtatorja. Arkitektin Ilir Cici, që kontribuoi në projektin e mjedisit ku është vendosur shtatorja".

Me këtë rast Këshilli i Bashkisë së Dibrës së Vogël-Peshkopisë, shpalli qytetar nderi të Peshkopisë, historianin Kristo Frashëri, për kontributin e tij në historinë e Shqipërisë dhe në zbardhjen e fakteve historike të Skënderbeut.

Ndërkaq Patricia Nuxhi nga Anglia, e njohur për grumbullimin e shkrimeve dhe librave për Skënderbeun përshëndeti të pranishmit dhe këtë solemnitet si edhe dorëzoi shumë libra të shkruajtur për Skënderbeun.

Këtë eveniment e nderuan edhe bashkëatdhetarët tanë me përshëndetje nga Italia, mes tyre edhe pasardhësi Aleksandër Kastriot Skënderbeu nga Leçe e Italisë.

Përurimi i shtatores së Skënderbeut u shoqërua me një program të pasur kulturor e artistik nga këngëtarët Qerim Sula, Ilir Shaqiri, Violeta kajtazi, Kastriot Tusha, Manjolla nallbani, Vera Laçi, Denada Krosi, Elonda Feta, Zyber Paci, dhe Mirush Kabashi që recitoi porosinë e Skënderbeut para vdekjes. Në ambientet e Qendrës kulturore u hap një ekspozitë me materiale e dokumente nga jeta dhe veprimtaria e Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Rexhep TORTE

Inagurim elektoral

Inagurimi i shtatores së Skënderbeut në Peshkopi, megjithëse nuk kishte të bënte me politikën, nuk mbeti jashtë saj. Organizatorët e kishin "zbukuruar" ceremoninë me disa postera elektoralë, çka i hoqi mundësinë kësaj veprimtarie të bëhej e njohur për publikun. Disa gazetarë të televizioneve qendrore, megjithëse ishin të pranishëm, nuk mundën ta pasqyronin këtë në media, pasi sipas tyre, kronika llogaritej si kohë elektorale.

Por përpos kësaj, edhe oratorët që folën në ceremoni, e shfaqën hapur bindjen e tyre politike. "Merita për këtë padyshim i takon Qeverisë me në krye Sali Berishën, si pasues i denjë i veprës europianiste të Skenderbeut, të rilindasve tanë, të Iljaz Pashë Dibrës, Ismail Qemalit, Dom Nikoll Kaçorit, Haxhi Vehbi Dibrës, Elez Isufit etj., duke ia kushtuar tërë qenien e tij bashkimit dhe europianizmit, duke ngritur dinjitetin e shqiptarëve në lartësitë e historisë, duke na bërë krenar për veten tonë", tha mes të tjerash kryetari i bashkisë së Peshkopisë, Ilir Krosi. Ndërsa kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli nuk ishte mes deputetëve të pranishëm në ceremoni, por kishte në krah kandidatët për deputetë të Partisë Demokratike. "Nuk ka gjë më të rëndësishme se sa të shohish ëndrën e erës sonë që po realizohet. Kush e kishte menduar 18 vite më parë se Shqipëria do të ishte kjo që është sot, se shqiptarët do të ishin qytetarë të NATO-s, se do të realizonim për dy vite e gjysëm rrugën Durrës-Kukës, ne po bëjmë edhe Rrugën e Arbërit, këtë rrugë patriotike që PD do ta vazhdojmë që në ditët e para të mandatit të ardhshëm. Edhe shtetet e BE-së do të votojnë pro Shqipërisë për në BE, sepse Shqipëria ka ndryshuar në të mirë".

Megjithatë, tani që fushata ka mbaruar, shtatorja e Skënderbeut është në qytetin e Peshkopisë dhe njerëzit çdo ditë që e shohin, kuptojnë se ajo nuk është vetëm një shtatore që përcjell vlera historike, por është edhe një vepër arti, e cila në vitet që vijnë do të jetë shumë e pëlqyeshme për t'u vizituar, parë dhe për të bërë një foto... bashkë më Skënderbeun.

SHKRUAN "GAZETA E ATHINËS

SKËNDERBEU "MBËRRIN" NË VENDLINDJE

Pas rreth 566 vjetësh, nga dita kur Ai me treqind kalorës u ndal në vendlindje, në Dibër, për të mbledhur krahun dhe trurin luftarak dibran për të mësy Krujën e për të krijuar shtetin e parë të bashkuar shqiptar, për të zhvilluar 25 beteja fitimtare kundër sulltanëve më të fuqishëm otomanë, 18 prej të cilave në luginën e Drinit të Zi, Gjergji i Gjon Kastriotit, vjen përsëri në Dibër. Vjen në "këmbë", pa kalin e tij legjendar, pa shpatën e tij të pathyeshme, vjen si qytetar i Peshkopisë...

Bujar Karoshi fiksoi në kujtesën time kompjuterike disa fotografi të Heroit tonë Kombëtar midis qytetarëve të Peshkopisë.

Më 9 qershor 2009, në një ceremoni të bukur në Bulevardin e Blirëve, ceremoni e organizuar nga Bashkia e Peshkopisë mysafirë ishin këngëtarë dhe artistë të mëdhenj të këngës e të teatrit si Kastriot Tusha, Ilir Shaqiri, Manjola Nallbani, Mirush Kabashi, Qerim Sula, Vera Laçi e të tjerë.

Për të pritur Heroin e kombit kishin ardhur dibranë nga qyteti i Dibrës së Madhe nën Maqedoni, shqiptarë të trojeve shqiptare nga Kosova, Tetova, Gostivari si dhe nga Tirana dhe qytete të tjera të Shqipërisë.

Skënderbeun monumental 3.3 metra të lartë, vepër e skulptorit Sadik Spahija, sponsorizuar nga biznesmeni dibran Zaim Krosi, "Qytetar Nderi" i Peshkopisë, e ngjitën në një piedestal 1,5 metra të lartë.

Ëndrra e dibranëve për ta pritur birin e tij të lavdishëm dhe për ta pasur gjithmonë pranë ka qenë e hershme por realitet ajo do të bëhej vetëm më se një vit më parë.

Dhe erdhi Gjergji i Gjon Kastriotit në Dibër, në trevën ku lindi dhe luftoi si dragua pikërisht në kohën kur kundër tij, për ta përdhosur dhe baltosur, ishin ngritur me tehun e penës së ndryshkur gjithfarë pseudofetarësh, pseudoshkencëtarësh e pseudoshkrimtarësh. Ngritja e tij në këmbë, pikërisht në Peshkopi, më 9 qershor 2009 është një përgjigje ndaj të gjithë atyre që duan ta bëjnë Skënderbeun dhe paraardhësit e tij sllav apo grek apo edhe tradhtar të Islamit...

Unë, në një sprovë për vendvendosjen e Gjergjit të Gjon Kastriotit, kam qenë i mendimit që monumenti i tij të vendoset në Sukën e Arrasit, në Sinë ku historianët shqiptarë kanë gjetur rrënjët e tij të vërteta, në Sukën e Arrasit, në atë karakoll natyror ku shihen si në pëllëmbë të dorës vendbetejat e tij fitimtare që nga Beteja e Torviollit e radhazi të tetëmbëdhjetë betejat mbarë.

Kam qenë i këtij mendimi edhe jam me ndjenjën ngrohëse të një mikut tim në Tiranë i cili më tha: "Le ta vendosin në Peshkopi. Skënderbeu është në këmbë dhe e din rrugën drejt vendlindjes..."

Bashkohem me të: Skënderbeu me siguri një ditë do t'i hipë kalit dhe me shpatë në dorë do të ngrihet MAL në qendër të Nëntë Maleve të Dibrës...

ABDURAHIM ASHIKU
Athinë, 10 qershor 2009

Zall –Dardha ka pak tokë, por shumë male, shumë trimëri e shumë këngë. Emigrimi masiv i ka tkurrë fshatrat e kësaj treve. Banorët janë zhvendosur në viset fushore, shumë shtëpi e kulla me emër janë braktisur dhe lëndinave të bukura plot lule u mungojnë ato këngët dhe vallet e hareshme që mbushnin jetën e këtyre maleve çdo ditë vere.

ZALL - DARDHA, DJEPI I ARTISTËVE

Me rastin e 60 vjetorit të shtëpisë së kulturës

Nga: **NAIM PLAKU**



Në këtë luginë të bukur, përmes këtyre brigjeve e shpateve të thepisura, gjarpëron Drini i Zi, duke prerë majtas e djathtas vargmalet e larta të Runjës e të Korabit, pasi lë prapa Qidhnën e viset e tjera të Dibrës për hyrë më pas në Lumë. Këtu shtrihet komuna e Zall-Dardhës ose Dardha e Dibrës me nëntë fshatrat e saj të mbështetur faqe malesh si fole dallëndyshesh, të banuar që në lashtësi, me një histori sa të pasur aq dhe heroike, me një popull trim e bujar, që luftoi kurdoherë me nder e dinjitet për të mbrojtur vatanin. Në këtë truall, ndoshta më mirë se kudo, lindën dhe u rritën si dy binjakë të përjetshëm besa dhe burrëria shqiptare, nderi dhe krenaria malësore, shpërtheu kaq bukur në këngë dhe valle patosi epik dhe shpirti lirik i banorëve të kësaj treve. Këtu qëndruan kaq pranë pushka dhe çiftelia, njera për ta mbrojtur e tjetra për t'i kënduar jetës e për të përjetësuar lavdinë. Këtu flet historia me tërë madhështinë e saj. Çdo pëllëmbë e kësaj toke është e mbuluar me ngjarje, me emra, me trimëri, me këngë...Gjurmët arkeologjike na flasin për vendbanime të hershme, siç është Çuku i Lekës, Kalaja e Zhugrit, Kisha e Qytetit dhe mjaft toponime të tjera që lidhen me qytetërime të lashta të kësaj treve.

Thuhet se kësaj lugine kaluan hordhitë e para osmane të komanduara nga Ali pashë Evranozi në fushatën e parë ushtarake për të gjunjëzuar Skënderbeun. Në vendin e quajtur Çadra e Pashës, këtu fare pranë Drinit, ai vendosi kampin ushtarak prej nga do të niste fushatën ndëshkuese ndaj prijësit të shqiptarëve. Në këto lëndina do të mblidheshin sa e sa herë kuvendet e maleve, do të lidhej besa e madhe e do të organizohej qëndresa heroike e malësorëve për të mos iu nënshtruar asnjë armiku. Ky vend, këto kulla të badha saherë u dogjën e u shkretuan, por kurrë nuk u përgjunjën, gjithmonë kënduan e do të këndojnë përjetësinë... Banorëve iu pëlqen ta quajnë veten dernjanë. Me këtë emër janë ndjerë krenarë në shekuj dhe ndjehen përsëri kudo që janë e ngado që shkojnë. Komuna ka nëntë fshatra: Zall – Dardhën, Lashkizën, Tartet, Merskanet, Nezhet, Soricën, Shënlleshet, Meneshet dhe Lugjet që etnikisht i përket kësaj treve, pavarësisht se ka kaluar shpesh herë për shkak të vendosjes në të djathtë të Drinit me Ujemujën. Dardha ishte një prej Nëntë Maleve të Dibrës që shkruan faqet më të lavdishme të historisë sonë në qëndresën antiosmane dhe pushtuesi otoman nuk guxoi kurrë të shkelë e të mposhtë krenarinë e këtyre maleve. Në luftën e Gjoricës kundër fushatës ndëshkuese të Hajredin Pashës dernjanët qen përkrah Nëntë Maleve të Dibrës duke treguar shembuj të rrallë heroizmi e trimërie në betejën e Gjoricës për të cilën do të këndonte më vonë aq bukur rapsodi i njohur, biri i Dardhës kreshnike, Hazis Ndreu.

Zall –Dardha ka pak tokë, por shumë male, shumë trimëri e shumë këngë. Emigrimi masiv në këto vitet e fundit, si kudo, i ka tkurrë fshatrat e kësaj treve. Banorët e dikurshëm janë zhvendosur në viset fushore, shumë shtëpi e kulla me emër janë braktisur dhe lëndinave të bukura plot lule u mungojnë ato këngët dhe vallet e hareshme që mbushnin jetën e këtyre maleve çdo ditë vere. Por dernjanët aty ku kanë shkuar e ngado kanë vajtur e kanë marrë me vete dhe këngën e vallen e tyre. Ajo ka shpërthyer fuqishëm në sheshe e podiume, ajo ka ndezur me tërë ngjyrat e bukura të ylberit skenat e qytërimeve anë e kënd botës. Artistët që morën zërin, bukurinë dhe krenarinë e këtyre maleve, kujtojnë me nostalgji këtë tokë që i lindi e i rriti, sjellin ndërmend të parët e tyre, traditat dhe zakonet e këtyre viseve, këtë vend që u dha emër dhe u fali talentin e mrekullueshëm, kulturën dhe begatinë shpirtërore të jetës artistike. Sot komuna e zall-Dardhës është një ekonomi modeste, por që jeton e punon për një të ardhme gjithnjë e më të mirë, jeton me shpresën se një ditë zërat e saj shtegtarë do të kthehen pranë kësaj foleje të vjetër.

Kënga ishte kronika e gjallë e atyre luftrave vigane që bëri populli ynë për liri e pavarësi. Ajo gdhendi në vargje e melodi ngjarje e portrete luftëtarësh, trimash e trimëreshash, heroi e heroinash. Ajo mbante erë baroti e ngjyrë gjaku duke sjellë ndër shekuj e vite lavdinë e qëndresës vigane të këtij populli për të mbrojtur lirinë:

Po e ngrejmë bajrakun
Në majë të kepit,
Në kambë janë çue
Dhe fëmijt e djepit...

Në epopenë e lavdishme të luftrave 9-vjeçare kundër pushtimit sërb të viteve 1912-1921 malësorët e këtyre anëve të udhëhequr nga patrioti i madh Elez Isufi treguan shembuj të shkëlqyer trimërie. Me thirrjen **"A besë- a besë"** dhe **" Bini, o trima, bini"** gjëmuan këto lugina, frymëzuan e hodhën në beteja për fitore " **shtatë e shtatëdhjetë**", burra, gra e fëmijë, **"veç për hatrin e këtij vatani".** Në ballë të kësaj qëndrese kujtesa popullore mban të pashlyet emra burrash të mençur e grash krenare. Në faqe betejash shkëlqyen emrat e trimave të Dardhës, që kënga popullore i ka skalitur dhe i mban në gjirin e saj si Misim Ahmeti e Tafë Shira, Ahmet Kaziu e Hysen Ndreu, Selim Hysa e Rrahman Rasha, Vesel Sula e Sulë Cani, Hysen Bara e Can Gjoka,, Met Kaca e Sadik Çera dhe plot të tjerë emra të nderuar.

Pas një qëndrese të gjatë kundër shovinizmit sërb, kur vendi ishte shkatërruar, djegur e përvëluar, ashtu siç e vajtonte dhe malësorja e këtyre anëve në ato ditë të vësht se

"Hiq kanun e mos ven lig,Kemi mbet si vath pa grigj ", u pa e udhës që të mblidhej në vitin 1921 Kuvendi i Dardhës, apo siç njihet ndryshe Kuvendi i Burrave të Dheut, që formuloi 13 paragrafët e një Kanunorje, e cila do të rregullonte jetën ekonomike e shoqërore për 23 vitet e ardhshëm e do të vepronte, gjersa do të vendosej përfundimisht regjimi komunist.

Hidhni një vështrim mbi këta vise që natyra i shpërbleu me bujarinë e saj! Nga brigjet e Drinit e gjer në lartësitë e maleve, mes këtyre bukurive, mes kaltërsive të qiellit dhe blerimit të luleve, ka jetuar në shekuj një popull i talentuar me burra azganë, të fuqishëm e shtathijshëm, me vajza e gra të bukura si zanat e shtojzovalleve, prej nga buruan visaret më të çmuara të krijimtarisë popullore, të folklorit të bukur e të pasur dibran, vargje e melodi si rrjedha e gurrave të këtyre bjeshkëve që kundërmojnë me lulezonja çdo pranverë. Në këto lëndina morën jetë e u rritën legjendat, ritet, këngët e vallet e bukura plot lirizëm të Ditës së Verës, të festave pagane të natyrës, ku u thurën gjithë ato kurora lulesh që hijeshojnë ballin e nuseve të reja.

" Kur të shkoni ju për lule,
thajrrmëni dhe mue,
merrmëni dhe mue...

Në këtë shtrat kaq të hijshëm të natyrës, në këtë mjedis me tradita e virtyte të çmuara, nisi jetën 60 vjet më parë Grupi Folklorik i Dardhës, pjesëmarrës i çdo festivali folklorik që nga qershori i vitit 1949 që shënon fillimin e tij e gjer sot, nga gjiri i të cilit do të dilnin herë pas here artistë virtuozë të këngës e valles, instrumentistë të talentuar e krijues të vargjeve dhe melodive, të gjitha të veshura me ata kostumet mahnitëse plot ngjyra e motive të rralla që aq bukur i ujdisi e i qëndisi dora e bardhë e gruas dernjane.

Por këta rrugë e këto lëndina u lanë dhe me lot hallesh e brengash, me lot nënash e nusesh që përcollën rrugëve të errëta të mërgimit dashuritë e sapoçelura të bijve dhe bijave, që fiknin rrezet e shpresës dhe hapnin plagët e rënda të kurbetit, plagë që lëngojnë e dhëmbin në kohëra të vjetra e të reja. E kush më bukur se Liri Rasha do t'u këndonte me kaq shpirt këtyre dhimbjeve, kush më bukur se ajo do të shprehte mallin me atë zërin e saj të përlotur që duket se del nga një gjoks i plagosur. Dhe zogu i verës shpesh do të qante e do të vajtonte së bashku me melodinë e fyellit apo mbi telat e çiftelisë së Sherif Dervishit

Së bashku me dallëndyshet e pranverës e bilbilat e malit do të vinte dhe Saje Poleshi e do të bashkonte me zogjtë e malit zërin e saj me aq patos e dinjitet artistik, do t'u këndonte bukurive të femrës malësore siç dinte ajo që nga grishja e këndshme ***" Moj zog-o, a i ke ba çorapt e djalit"*** e pastaj zana e krojeve do të që qëndronte përkrah djalit të zgjedhur duke zbritur nga bjeshkët si thëllëzë, tërë shëndet e bukuri, bardhë e kuq si molla, medisdrapër e me shtatin selvi, me flokët korb të zinj, ajo e bardha, e mira, e ëmbla vajzë malësore porsi hënëza e Korabit.

Po kaq të bukura dhe të vyera sa ritet e natyrës ishin dhe ato të dasmës dernjane me ritet, këngët dhe vallet origjinale që e shoqëronin atë. Tashmë kanë hyrë në fondin e artë të folklorit tonë kombëtar vallet e bukura burrërishte dhe grarishte që i gjurmoi ndër vite dhe na i solli në skenë një nga drejtuesit më me emër të këtij grupi, Xhelal Çerpja. Mjafton të kujtojmë vallen e luleve, horet e grave, Vallen e Hallave, vallen brilante epike të Kuvendit, e cila bëri jehonë në skenat më në zë dhe skaliti edhe më fort identitetin e kulturës sonë kombëtare brenda e jashtë atdheut.

Grupi folklorik i Dardhës, që u krijua në vitin 1949, lindi si një domosdoshmëri, si një nevojë e kohës për të shpalosur në sytë e botës artin e një populli, historikisht të munguar në skenat e Evropës, si një pasqyrë e kulturës së një kombi që kishte shumë për t'i thënë e për t'i dhënë njerëzimit, se kultura nuk njeh të madh e të vogël, se arti nuk njeh kufinj. Nuk është më sinjifikativ rasti i grupit folklorik të Dardhës që pati në gjirin e tij mbi 300 artistë amatorë, me një veprimtari të vazhdueshme kulturore 60- vjeçare, amatorë të rinj e të vjetër, të gjithë të varfër, me shkollë e pa shkollë, por të gjithë artistë të vërtetë, që i bashkonte aty, në ballin e skenës, talenti, dashuria dhe trashëgimia e vyer, e cila buronte nga thellësia e shekujve, me një dëshirë dhe një gjen, që rrallë i bashkon në simbiozë sakrificën dhe dhuntinë njerëzore. Në këtë djep artistësh lindi dhe u zhvillua talenti i rrallë i Muharrem Xhedikut, një prej kompozitorëve më të shquar. Prej këndej mori forcë e jetë krijimtaria e tij, për të krijuar ato relike të çmuara të këngës popullore, që ai i kultivoi me aq dëshirë e pasion. Këtej buroi dhe krijimtaria e pasur letrare, Lutfi Ndreut, Beshir Calës, etj.

Prej këndej do të vinte Artisti i Merituar, Hazis Ndreu, zëri dhe këmba e të cilit do të shkelte skenat e botës, një folklorist dhe krijues i talentuar, një historian dhe poet, një koreograf dhe publicist, një etnograf dhe studiues i kulturës dibrane. Këtej mori emër dhe u rrit së bashku me këngën lirike Artistja e Merituar, Liri Rasha, ajo vajza e brishtë dhe e bukur që zbriti prej këtyre maleve për t'i dhënë atdheut të saj hijeshinë e këngës popullore. Ky ansambël pati vallëtarë e instrumentistë të shquar si Rexhep Topuzin e Hysen Ndreun, Lazam Sulën e Arif Hysën , Ali e Avdi Ndeun, Muharrem Sulën e Destan Ramën, Xhelal Çerpen e Rufat Ymerin e shumë e shumë artistë virtuozë. Që në vitin 1950 do të zgjidhej dhe do ta përfaqësonte në festivalin e Moskës një grup vallëtarësh të talentuar, që u bënë laurat të çmimit Ndërkombëtar e më vonë herë pas here do të nderohej me medalje e çmime në shumë takime e festivale folklorike që nga viti 1968 e në vazhdim. Prej këndej kumboi zëri patetik i këngëve epike të Shaban Mëziut e Qerim Sulës, që dukej se shpërthente prej frengjive të kullave të lashta e mbushte me frymëzim brezin e ri. Që nga Isuf Topuzi e Xhevahire Cani, Hazbie Rasha e Defe Ndreu, Flora Çerpja e Metush Luca, Naim Cala e Sherif Dervishi e gjer tek më rë rinjtë e sotëm, në shumë veprimtari kulturore do të shënoheshin kulme të reja, vlera të tjera, që do t'i jepnin Zall- Dardhës emrin e merituar si djepi i artistëve.

Shtëpia e Kulturës e Zall –Dardhës do të bëhëj një qendër e rëndësishme e grumbullimit dhe e kultivimit të vlerave artistike të kësaj treve. Ajo shërbeu ndër vite jo vetëm si vatër argëtimi, por edhe ku mbinin e piqeshin talentet, ku vlonte jeta artistike e gjallëronte çdo ditë nga zërat rinor. Nuk ka asnjë veprimtari artistike që, për më shumë se gjysëm shekulli të mos jetë ndjerë e përfaqësuar Zall- Dardha, që të mos jenë shfaqur talente të reja, që të mos jenë shënuar arritje e suksese të reja në art e kulturë. Ndaj sot, në këtë 60 vjetor drejtojmë mirënjohjen e madhe ndaj gjithë drejtuesve të këtyre veprimtarive kulturore- artistike që nga themeluesi i saj Qazim Selimi e në vazhdim me Shaqir Shirën, Hysen Çerën, Halil Lushin, Arif Ramën, Avni Ndreun, Hafiz Shehun e gjer tek i nderuari Xhelal Çerpja që prej 40 vitesh drejtoi këtë institucion me një dashuri e profesonalizëm të veçantë duke e bërë këtë Shtëpi Kulture, jo vetëm si qendër argëtimi, por edhe si një vatër e grumbullimit të vlerave burimore folklorike, e pasqyrimit të trashëgimisë së pasur kulturore dhe e njohjes e nxitjes së talenteve të reja në të gjitha fushat e artit e të kulturës. Grupi folklorik i Dardhës ka qenë gjithmonë në vemendjen publikut e në pritjen e prurjeve të reja artistike, se shpirti i popullit nuk vdes, se arti, që buron prej shpirtit nuk njeh lodhje, se talentet mbijnë kurdoherë në një truall me tradita. Prandaj sot, e përmot do të kemi ngjitje të reja, emra të rinj, kulme të reja, përvjetorë të tjerë.

reportazh

Të gjithë fshatrat pothuaj që kishin ndryshura në pamje.
Komunat po punonin për sistemimin e rrugëve, por dhe të mirëmbajtjes së tyre.
E rëndësishme ishte se kudo kishte ngritje të shtëpive dhe mirëmbajtje të tyre.

Pranverë në Dibër



Pamje e fshatit Radomirë/ Foto: B. Zotaj

Gjëja e parë që na ra në sy, ishte se kudo po punohej dhe njerëzit ishin në lëvizje. Toka të punuara e të sistemuara, shtëpi të reja dhe në ndërtim, rrugë që po zgjeroheshin dhe mjaft lëvizje të makinave.

Nga: **DR. BERNARD ZOTAJ**

Më rastisi që me një grup mësimor të studentëve të Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu", këtë pranverë të merrja pjesë në një udhëtim historik, njohës dhe mësimorë. Për Dibrën dhe dibranët kam dëgjuar dhe në vetvete kisha krijuar respekt dhe vëmendje për traditat, kulturën dhe mbi të gjitha për patriotizmin e burrërinë e tyre në shekuj.

Në këtë zone të madhe e që Dibra është e ndarë në dy shtete, Skënderbeu ka zhvilluar mjaft beteja të lavdishme, të cilat janë të njohura për ushtarakët, por dhe për studiuesit. Në vazhdimësi punohet që këto të njihen si nga të rinjtë por edhe më gjerë. Fakt është se secila nga këto beteja ka një histori, një gojëdhanë apo qoftë edhe një legjendë që ende tregohen nga vetë vendasit. Ja, për këto kanë nevojë të rinjtë që të mësojnë, por edhe ti shkruajnë dhe interpretojnë për historinë e tyre të hershme dhe të sotme. Shumica e njerëzve kanë njohuri të mjaftueshme për to, edhe pse disa nga këto beteja janë mveshur me legjenda.

Gjëja e parë që na ra në sy, ishte se kudo po punohej dhe njerëzit ishin në lëvizje. Toka të punuara e të sistemuara, shtëpi të reja dhe në ndërtim, rrugë që po zgjeroheshin dhe mjaft lëvizje të makinave.

Qyteti i Peshkopisë të mrekullon me gjelbërimin, me pemët dekorative, me rrugicat e pastërta e të sistemuara dhe me njerëzit bujarë e punëtorë. Shëtitën më qytet dhe përshëndetëm të njohur dhe të panjohur. Kudo mirësi dhe respekt.

Shkuam në një farmaci se një student kishte shqetësime. Morëm një ilaç dhe na shoqëroi për në urgjencë një pjesëtarë i farmacisë. Pasi bëmë vizitën në urgjencë, bëmë ilaçin dhe u shëruam u kthyem dhe j'ua dhamë lekët. I falënderuam për ndihmën që na dhanë e cila ishte e menjëhershme.

Udhëtimin e bëmë nga Kalaja e Dodës për në Kukës. Gjatë rrugës shikonim përsëri burra e gra që punonin në ara. Aty pamë që gruaja korrte me kosore, që me sa dime, është një punë e vështirë për burrat dhe jo më për gratë. Më tej fëmijë që me grupe shkonin në shkolla deri edhe një orë në këmbë. Disa i morëm në autobuzit tonë që t'u shkurtonim kohën. Na thanë se këtë rrugë e bënin çdo ditë dhe me mësime ishin mirë. Na falënderuan dhe na uruan rrugë të mbarë.

Gjatë rrugës ndeshëm dhe në kope me dele që shkonin për të veruar në shpatet e malit të Korabit, por dhe të pllajave e të kodrave të krahinës që tashmë ishin të mbuluara me bar dhe lloje të ndryshme lulesh. Në këtë zonë kishte dhe mjaft bletërritës, kudo në shtëpi kishte zgjoje me bletë.

Kalaja e Dodës, është një krahinë e madhe e cilë është në rrjedhën e sipërme të përroit të Veleshnjës. Fshatrat vijnë me radhë, që edhe mund të mos i vendos siç vijnë, për mungesë njohje, por ato janë: Cereni, Radomirë, Ploshtam, Vasiaj e Shulla. Nga burimet e bollshme që ka zona diku pamë dhe një mulli i cili përsëri bluante misër dhe grurë, që fermerët e bënin në tokën e tyre. Pas kaq vitesh aty pashë dhe thekër e cila ishte e shëndetshme dhe që kërkohej në treg.

Qyteti i Peshkopisë të mrekullon me gjelbërimin, me pemët dekorative, me rrugicat e pastërta e të sistemuara dhe me njerëzit bujarë e punëtorë. Shëtitëm më qytet dhe përshëndetëm të njohur dhe të panjohur. Kudo mirësi dhe respekt.

Pamje nga qyteti i Peshkopisë / Foto: B. Karoshi


Shkollë e re në Kala të Dodës/ Foto: B. Zotaj

Të gjithë fshatrat pothuaj që kishin ndryshura në pamje. Komunat po punonin për sistemimin e rrugëve, por dhe të mirëmbajtjes së tyre. E rëndësishme ishte se kudo kishte ngritje të shtëpive dhe mirëmbajtje të tyre. Në Kalanë e Dodës kishte shkollë të re e të mirëmbajtur, deri të tri kate. Aty kishte shumë varre të vjetër dhe me mbishkrime, ishin 200-300 vjeçarë, por të pa rrethuar e që mund edhe të shkatërroheshin. Ndërsa vorrezat e fshatarave ku kaluam ishin të rrethura dhe të sistemuara bukur dhe me kulturë.

Në një kodër të veshur me bar dhe pisha ishin të vendosur tërë varret e luftëtarëve të krahinës me në krye udhëheqësin e kryengritjes së armatosur në krahinën e Dibrës Elez Isufi. Ai ishte një prijs popullor që përkrahu qeverinë e Vlorës, u përlesh me forcat serbe në vitin 1912, udhëhoqi kryengritjen në vitin 1920-1921 që ushtria serbe donte ta mbante të pushtuar këtë krahinë luftarake e me tradita të flakta atdhetare.

Bukuritë natyrore dhe monumentet e natyrës në këtë krahinë janë të pranishme kudo. Aty në muajt e beharit vijnë pushues për klimën e pastër dhe natyrën e bukur të kësaj zone e krahine.

Nga ky udhëtim morëm shumë gjera të mira me vete, por kryesorja është se atje shteti dhe vendorët duhet të vënë dorë. Rruga, që është dhe më kryesorja duhet të jetë e pranishme dhe t'ju vijë në ndihmë njerëzve, por edhe turistëve.

Kjo krahinë të mahnit me bukuritë, të shlodh me pamjen, të freskon me ujin e pastër dhe të ftohtë, të mbush me frymë nga aroma e luleve dhe freskia e malit të Korabit. Respekt dhe mirënjohje për gjithë ata burra, gra e fëmijë që jetojnë në këtë vend të begatë, por të harruar nga njerëzit e ...



DIBËR E MADHE MANIFESTIMI "DITËT E KULTURËS-DIBRA 2009"

Verë me plot aktivitete kulturore e sportive

Siç na informoi Ylli Mirzo, këshilltar i kryetarit të komunës, këtyre ditëve nën patronatin e z. Argëtim Fida, kryetar i Komunës Dibër e Madhe, filloi manifestimi « Ditët e kulturës-Dibra 2009». Ky manifestim do të zgjatën nga korriku deri në shtator, dhe do të mbahet në praninë në edhe të mijëra mërgimtarëve, të cilët vijnë në vendlindje për t'i kaluar pushimet verore. Atyre do tu prezentohen vlerat kulturore e sportive në atmosferën e çasteve zbavitëse dhe rekreative.

Priten të zhvillohen aktivitete të larmishme, duke prezentuar edhe vlerat kulturore të të gjitha bashkësive etnike që jetojnë në këtë komunë.

Aktivitetet kryesisht do të zhvillohen në lëmin e muzikës, folklorit, teatrit, krijimtarisë letrare, artit figurativ, turneut në futboll të vogël, kajak dhe kanu etj.

Këto aktivitete filluan me dramën e gjimnazistve dibranë , ndërsa para disa ditëve u shfaq edhe drama «Buri im ka zero kilometra» me regji të Mitro Kutalit dhe me aktorët Juliana Deda, Gentian Zenelaj dhe Rozana radi, protagonistë të spektaklit «Portokalli».

Gjatë kësaj vere ambientet e Qendrës Kulturore në Dibër të Madhe dhe poligonet sportive do të jenë arenë e këtyre aktiviteteve, duke filluar me garat në futboll të vogël, basketboll, koncertin e SHKA «Haki Stërmilli», të SHKA «Zepishtë», Dasmën rome, Portikun letrar «Dr.Lutfi Turkeshi» dhe Regatën ndërkombëtare në Kajak dhe Kanu në Liqenin e Dibrës së Madhe.

Këto aktivitete do të kulmojnë me shënimin e 100-Vjetorit të Kongresit të Dibrës që do të mbahet nga data 23 dhe 24 korrik dhe me Festivalin «Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2009».

Rexhep TORTE

Rruga Arbërit nr. 38

Miqtë e Katër Grykasve janë të shumtë, ato shtohen dita ditës.



Të njohim vendlindjen

Katër Grykët, vlerë e rrallë e etnografisë kombëtare

Nga: **MEVLUD BUCI**

Katër –Grykët, një nga zonat e Dibrës(mal në Dibër e bajrak në Mat) shtrihen në perëndim të rrethit Dibër. Katër grykët për vetë relievin e tyre kanë qënë një kështjellë e tërësisë tokësore të atdheut. Përse e mbajnë një emërtim të tillë, të përbashkët? Ky përcaktim është për vetë relievin e kësaj zone që janë gryka e Murrës e cila lidhet me Matin, gryka e Pllaut që lidh Lukanin me krahinën e Lurës, gryka e Kacnisë që lidhet me Bulqizën dhe gryka e Selishtës që lidhet me Muhurrin. Fshatrat që bëjnë pjesë në këtë zonë tashmë janë: Qafmurra, Murra e vjetër, Selishta e Epërme , Selishta e Poshtme, Kacnia dhe Lukani. Fiset e këtyre fshatrave janë të shumta. Ato janë të trajtuara bukur në historikun në dorëshkrim të Nazif Ramës. Fisi më i vjetër sipas këtij dorëshkrimi është Marku që sot quhet Cemenja dhe Gjoka në Selishtë të Poshtme. Tre fise të tjera të ardhura më vonë janë Skënderi sot: Fera, Bardhi, Sula, Dalipi, Delishi, Xheka në Selishtë të Epërme. Sinani e Hysa sot përbëhen nga këto fise: Cani, Hida, Muça, Bodini, Lasku, Manuka dhe Sela. Hani përfshin këto fise: Meta, Roka, Loca, Hasa, Pepa dhe Kaziu që sot ky i fundit nuk ekziston në Selishtë të Poshtëme. Nga Selishta ka mjaft fise që ekzistojnë në zonën e Dibrës si Maqellarë, Dibër e Madhe e gjetkë. Në fshatin Lukan sipas gojëdhënës fisi më i vjetër ishte fisi Arushaj që sot janë: Ndreka, Pepa dhe Zholi . Në këtë fshat ekzistojnë këto fise: Totraku, ku bëjnë pjesë; Lleshi, Buci, Lami, Sula, Bushi, Loshi dhe Koka. Fisi Bruçi e Ndregjoni janë një kabile kurse dy fise të tjera sipas toponimeve (Koleci dhe Konesha) janë shpërngulur në Katund të Ri. Në fshatin Kacni kanë ekzistuar fiset Losha, Margjoka, Pjetri, Lica, Luli, Marleka dhe Mjeshtri. Losha është një fis i pandryshuar vetëm se ka të mbështetur fisin Murati i ardhur ky nga Gur-Lura bashkë me fisin Kalia. Margjoka sot përbëhet prej tre fisesh Mark-Gjokë, Han-Alie dhe Rama, ndërsa Kalia ka ardhur më vonë. Pjetri përbëhej nga tre fise: Bajram Rizanaj, Demir Osmanaj, Cenaj, Brahimetaj dhe Kazia që sot ndodhet në Kurdari të Matit. Në fisin Lica bëjnë pjesë: Demir Zeneli, Fali Lami dhe Lici. Fisi Luli nuk ekziston në Kacni, është vetëm një familje që ekziston në Gjoricë me mbiemrin Kacnia. Fisi Marleka nuk ekziston. Fisi Mjeshtri janë sot Elezajt në Kodërrasë, ndërsa Bruçi e Milloshi kanë ardhur vonë. Në Qafëmurrë fisi më i vjetër është Manreka që ekziston edhe sot. Fiset e tjera janë Lala, Miha, Lleshi, Biba, Prejsi dhe fisi Kolthatej që bëjnë pjesë fiset Perhati e Duka. Sipas këtij dorëshkrimi të gjitha fiset e Katër Grykëve janë të ardhur nga zona e veriut dhe sidomos nga Mirdita. Katër Grykasit kanë qenë gjithmonë bashkë në një unitet për ta pasur zili, bashkë edhe në luftrat e gjata që kanë zhvilluar dibranët kundër pushtuesve të huaj. Kur ka qenë nevoja për të mbrojtur vatanin Katër Grykasit kanë shkuar në ndihmë edhe matjanëve dhe kanë luftuar në të njëjtën llogore me ta. Qëndresa e uniteti i Katër Grykëve hedh dritë në mjaft ngjarje e luftëra të përgjakshme për çështjen kombëtare. Në ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit e Kuvendet e Dibrës, në betejën e nëntorit 1912, në kryengritjen e shtatorit 1913 Katër Grykasit kanë dhënë ndihmesën e tyre. Kur plagosën bajraktarët e Lurës e Matit(Kthellës) trimi Ismail Nika nga Qafmurra nuk i la ata, por në mejdan të luftës i merr si i ka hije. Epoka historike e vitit 1912 thotë:

"Ali Mena ni trem çallak
kush ta kapi çat bajrak
Smail Najka ma ka kap
Smail Najka ni trem drague
tre bajrakët si la me u rrzue. . "

Populli i Katër Grykëve i bashkuar me popullin dibran luftoi kundër serbëve duke e çuar frontin e tij deri në Vllanicë afër Gostivarit. Në këto beteja krahas mjaft dibranëve që u martirizuan ranë edhe djemt e Katër Grykëve si Sefer Bodini(Hoxhë Bodini), Sali Bodini, Bajram Buci(Hoxhë Buci) me të birin, Mustafa Buci, Haziz Lasku, Mehmet Sula, Xhafer Hasbajrami, Selman Rama, Haziz Hysen Lala, Ymer Margjoka. Nuk mund të lëmë pa përmendur se në kohën e Lidhjes së Prizërenit Abdyl Frashëri qëndroi një natë tek fisi i shquar Hasbajrami në Kacni sepse kishte shoqëri në Stamboll me Mustafa Hasbajramin e asaj kohe. Në betejën e Kakarriqit kundër malazezëve ranë Isuf Budi, Selman Dervishi, Nezir Demir Lica. U plagosën Ismail e Hasan Nika. Në këtë betejë vërtet të përgjakshme Katër Grykasve u printe Halil Doçi nga katundi Murrë të vjetër. Në Katër Grykë ka patur ekzistuar një itifak(besëlidhje) që ai që bënte poshtërsi në zonë, vjedhje apo imoralitet shpërngulej nga krahina dhe ky vendim merrej fshatçe. Rezistenca e katër Grykasve karshi pushtuesit ka qenë e madhe dhe kjo tashmë është e skalitur me germa ari në historinë tonë kombëtare. E paharruar mbetet ende në kujtesën e të gjithëve qëndresa në Nish(Kala të Kuqe) ku heroizmi i djemve Katër Grykas është skalitur në këngë:

" Vajsh Manuka me openga
Kalasë së Kuqe i hini mrena
Vajsh Manuka asht betue
Ushtrinë turkut me ia farue
Shaban Margjoka ni burrë i zi
Thotë ja shahit ja gazi
Kurt Koltraka e Shaban Margjoka
I venë turkut nëpër topa
Se shqiptarët e kanë zakonin

Nuk ta lshojnë të gjallë vatanin…"

Po kështu Katër Grykasit i kanë rezistuar dhe shtypjes feudale në vend. Hoxholli kishte Pratin e Selishtën. Karasani merrte argat e i punonin tokat. Ali Koka u ngrit kundër këtij fenomeni feudal dhe nuk e dërgoi gruan e tij të punonte tokat e Karasanit. Pas pak e kapën Ali Kokën dhe e dogjën me kunja pishe në trup. Populli e përjetoi në këngë:

" Ali Koka ni trem drague
Krejt u dogj e shkrumue
E la t've gruen e re
faqebardhë hini në dhe
s'ja çoj gruen Karasanit
qenit të rregjun të Osmanit
po për nder u ba razi
dogji shtatin si qiri…"

Katër Grykët kanë plot ngjarje që janë përjetuar tashmë në histori . Veçori në këtë zonë mjaft të bukur e të njohur është edhe folklori aq i pasur dhe i bukur ku djemtë dhe vajzat e Katër Grykëve kanë ngjitur skenat ane mbanë vendit. Vetë relievi piktoresk i kësaj zone të jep mundësinë për ta kthyer në një turizëm malor. Mjafton të ndërhyhet në infrastrukturë dhe kjo do të bëhet një nga zonat më të shkelura pse jo nga turistët e huaj për vlerat e rralla historike e kulturore që mbar. Katër Grykët janë një trevë e mrekullueshme, e pasur me pyje, ujëra, liqene, pasuri minerale. Minerali i kromit në Kacni, asbesti në Selishtë, pyjet e Bufullës, të Pratit, Balgjajt, Xhelasit, Vanasit e plot të tjera si këto. Pyjet e ahut dhe lisit vërtet janë të rralla në të gjithë zonën e Dibrës. Vende të bukura turistike janë liqenet e Kacnisë, Prati, Gërshajza (Vanas). E përshtatshme për ngritje hidrocentrali është Gryka e Selishtës ku lidhet me Muhurrin. Diga nën Rrasë të Bardhë në Bufull. Të gjitha këto resurse të mira që rrallë zona i kanë nuk kanë asnjë vlerë sot pa u rregulluar infrastruktura e plotë. Zona e Katër Grykëve është një zonë mjaft arsimdashëse dhe këtë e kanë treguar herët kur atëherë vihej në dyshim edhe gjuha shqipe. . Flitet ende në popull se Hoxhë Buci qysh në vitin 1908 ka mësuar gjuhën shqipe fshehurazi në mejtepin e tij në Selishtë. Shkolla e parë shqipe u hap në Qafëmurrë më 12 dhjetor 1925 me mësues Mahmut Trimin nga Shëngjergji i Tiranës. Filluan mësimin 30 nxënësit e parë ku nga këto të gjithë ishin djem e vetëm një vajzë Alije Hasbajrami. Shkolla u mbyll më 5 shtator 1928. Më 1935-1936 u rihapën dy shkolla fillore:Në Murrë bashkë me Lukanin dhe në Selishtë bashkë me Kacninë. Në këto shkolla kanë dhënë mësim mësues të nderuar si Hamza Vlashi, Preng Filopati, Hysen Abdihoxha, Jorgji Shuteriqi, Abedin Shehu, Kadri Abdihoxha etj. Kushdo që ka shkelur për herë të parë në Katër Grykë, ka mbetur gjithmonë mik i kësaj zone. Dashje pa dashje këmbët e kanë sjellë përsëri në këto anë, ndaj dhe miqtë e Katër Grykasve janë të shumtë, ato shtohen dita ditës.

Luznaku, kampion i Ballkanit në mundje



Para pak javesh ne qytetin e Peshkopise tek Ura e pazarit mësova rastësisht sesi 13 vjecari nxënës i klasës 7-të në Peshkopi Nehat Uzri Seferi nga treva e Luznise, mbante 15 medalje ari për mundje. U interesova dhe e takova vetëtë këtë mundës të talentuar të peshës 35 kg Nehat Seferi. Ajo që më befasoi ishte pasioni, thjeshtësia, mençuria, prej luznaku fisnik. E përqafova dhe e urova: "Të lumtë luznaku i ri, të lumtë kulla e Seferit! . Nxënës i dalluar në shkollën ku mëson e mbi të gjitha një mundës që premton për shumë. Me tuç ka fituar 15 medalje ari. S'ka më gëzim e kënaqësi kur dëgjon e mëson për fëmijë të talentuar si Nehat Seferi . Fitoret e mia, thotë Nehati i vogël ia kushtoj Luzmisë, Dibrës time por unë jam I bindur se nuk do të kisha arritur deri këtu pa këmbënguljen e madhe të trajnerit tim Fiqiri Rama. Jo vetëm unë por i gjithë ekipi i mundjes kemi përfituar shumë nga trajnier Fiqiriu. Nehati ka marrë tre medalje ari në vitin 2008 në Shkup ku u shpall kampion i Ballkanit. E sot gjithsejt mbart plot 15 medalje ari. Një thirrje për vetë shtetin, për bashkinë e Peshkopisë, për individ e biznesmen, dashamirës të sportit të mundjes. Duhet të ndihmohet sporti i bukur i mundjes dhe kur ke talente të tilla si Nehat Seferi. Babai Uzriu, nëna Fatbardha, vëllai Nuredini, motra Aurela, daja Riza Erebara, kushërinjtë si Xhelal, Seferi e plot të tjerë krenohen me luznakun e ri të tapetit të mundjes por më tepër krenohet Dibra për këtë talent që ka , krenohet ekipi i "Korabit" që e ka nderuar sa e sa herë .

M.B.

traditë

Ku janë urat e Dibrës së Madhe?

Nga: **Rexhep TORTE**

Pozita gjeostrategjike dhe populli heroik e liridashës dibran bënë që Dibra e Madhe të zë vend të merituar në historinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë më së miri flet e kaluara historike me periudha të lulëzimit por edhe me periudha të lara me gjak, për këtë flasin edhe urat e bukura të Dibrës së Madhe brenda në qytet.

Ndër urat më në zë e më të mëdha janë Ura e Spilës e ngritur mbi vendin ku bashkoheshin lumenjtë Drini i Zi dhe Radika dhe Ura e Radikës e ngritur mbi lumin Radikë. Këto ura ishin edhe lidhja e Dibrës së Madhe me botën.


Pamja e bukur dhe impozante e këtyre urave, mënyra e përkryer e ndërtimit arkitektonik dhe roli komunikues lokal, krahinor e ndërkombëtar, ishin pasqyrimi më mirë i rolit të Dibrës së Madhe në rrjedhat historike, që shumë historianë me të drejtë e quanin edhe porta e Shqipërisë.

Për këto dy ura më të mëdha kanë shkruar edhe historianët Bue, Baldaçi dhe Jastrebov.

Konfiguracioni i thyer i terrenit ku është ngritur qyteti i Dibrës së Madhe dhe përrenjtë e furishëm që sjellin ujin nga malet sipër qytetit, kishin kushtëzuar ndërtimin edhe të shumë urave brenda në qytet, më të vogla për nga dimensionet, por të bukura e funksionale, që lidhnin brendapërbrenda qytetin dhe bënin më komod kalimin e njerëzve nga një lagje në lagjen tjetër.

Reliket e mbetura të këtyre urave në kujtesë, në fotografi apo edhe në vendin ku kanë qenë ndërtuar, tregojnë për rëndësinë dhe madhështinë e tyre shumëdimensionale, funksionale, kulturore e historike, të cilat edhe me fajin e dibranëve u lejuan që të shkatërrohen dhe humbin, siç thotë populli, pa nam e pa nishan.

Për të sistemuar ujin e përroit që vinte nga fshati Elevcë dhe Përroin e Vakofit, ishin ndërtuar Ura e Bejlerëve, Ura e Kuqe, Ura e Çezmës së Madhe, Ura e Selamit, Ura e Vakofit dhe Ura e Këllëçbabës.



Ura e Kaprollit



Urën e Radikës e vodhën maqedonët

Këto ura ishin të ndërtuara vetëm prej guri, por kishte edhe të atilla të ndërtuara prej guri, hekuri dhe druri.

Këto ura për fat të keq sot nuk ekzistojnë, përveç një pjese të Urës së Çezmës së Madhe dhe të Urës së Këllëçbabës. Kjo ka ndodhur sepse rrugët janë rrafshuar dhe mbuluar me pllaka betoni, ndërsa urat në brendi të qytetit janë prishur. Po qe se do të aktivizohen përrenjtë, në mungesë të kanalizimeve, uji do të rrjedhë në sipërfaqe të rrugës.

Urën e Spilës, të gjatë afër 50 metra me dy harqe-qemerë të mëdhenj në mes dhe me nga një harkqemer shkarkues anash, që ndodhet në vendin ku bashkohen lumenjtë Drini i Zi dhe Radika, e kanë ndërtuar në shekullin e 17 mjeshtrit dibranë. Kjo urë është financuar nga dibrani Haxhi Ibrahim Hatibi. Ky dibran i pasur me që nuk ka patur fëmijë, për simbolikë të një djali financoi ndërtimin e xhamisë në qendër të qytetit dhe për simbolikë të një vajze, ndërtoi Urën e Spilës.


> Po të ekzistonin sot ato ura të shkatërruara, me bukurinë dhe atraktivitetin që kishin, do tia kthenin imazhin e merituar Dibrës së Madhe

Kjo urë është ndërtuar me gurë mermeri të lidhur me një masë gëlqereje shumë efektive dhe me shufra hekuri. Për këtë urë ekzistojnë shumë gojëdhëna. Thuhet se pas përfundimit të kësaj ure, rastësisht ka kaluar një dhelpër skile, dhe që atëherë kjo urë është quajtur Ura e Skilës, që më pastaj transkribohet Ura e Spilës. Për nga funksionaliteti, kjo urë ka qenë në kuadër të Via Egnatia dhe ka lidhur Dibrën e Madhe me Strugën, Ohrin, Manastirin etj.

Fotografia e kësaj ure është bërë nga Milton Manaki më 16 korrik 1909, i cili ka fotografuar konsullin austriak me makinë mbi urë, pas kthimit të tij nga Kongresi i Dibrës ku ka qenë pjesëmarrës edhe vetë.

Urën e Spilës, këtë urë me bukuri të rrallë, e shkatërroi ushtria serbe gjatë luftërave Ballkanike. Më vonë ajo u rinovua, por me pamje më të thjeshtë, derisa u hoq fare me ndërtimin e digës së Liqenit artificial të Dibrës dhe të të hidrocentralit Spila po në atë vend.

Ndër urat më në zë e më të mëdha janë Ura e Spilës e ngritur mbi vendin ku bashkoheshin lumenjtë Drini i Zi dhe Radika dhe Ura e Radikës e ngritur mbi lumin Radikë.



Urën e Spilës që e rrëzuan serbët

Ura e Radikës ishte ndërtuar mbi lumin Radikë aty ku përfundonte gryka e Radikës dhe ku fillonte Fusha e Udovës-hambari i Dibrës i Dibrës së Madhe. Kjo urë fillimisht ka qenë ndërtuar gjatë periudhës ilire dhe romake në shekullit e dytë të e. s. , ndërsa me pamjen që shihet në fotografi, është ndërtuar në fund të shekullit 18 gjatë periudhës osmane.

Gjatësia e kësaj ure është 40 metra. Ura ka harkun-qemerin në mes të gjerë 21 metra dhe të lartë 12 metra, ndërsa dy harqet-qemeret anësorë kanë gjerësi afër 9 metra, që shërbenin gjithashtu për shkarkimin e ujërave të furishëm së bashku me dy dritaret anësore. Ndërtimi i kësaj ure gjithashtu është bërë prej mermeri dhe guri i lidhur me masën e gëlqeres dhe me shufra hekuri.

Kjo urë lidhte më shumë se 20 fshatra dhe Kështjellën e Skënderbeut, që ndryshe quhet kështjella e Koxhaxhikut ose Svetigradit, dhe ka shërbyer si degë e Via Egnatia.

Me rastin e akumulimit të ujit të liqenit të hidrocentralit në Dibër të Madhe në vitin 1966, kjo urë u dislokua me ndihmën e arkeologëve, të cilët shënuan çdo gur me numër të caktuar sipas vendit ku ndodhej, që më pastaj siç ishin premtimet e Entit republikan për mbrojtjen e monumenteve kuturore e historike në Maqedoni , kjo urë do të rindërtohej mbi lumin karshi fshatit Kosovrast.

Mirëpo siç ndodhi edhe me shumë monumente tjera kulturore e historike të Dibrës së Madhe gurët e kësaj ure vitin 1985 u humbën përgjithmonë.

Nëpër Urën e Spilës dhe Urën e Radikës kanë kaluar karvanët me mallra në drejtime të ndryshme dhe ushtritë nga më të ndryshmet.

Mbi Përroin e fshatit Gajre, që është degë e lumit Radikë në rrugën për në fshatin Mogorçë ndodhet edhe Ura e Kaprollit. Lidhur me këtë urë ekziston gojëdhëna se një pasha turk gjatë gjuetisë ka plagosur një kaproll, i cili edhe pse i plagosur fluturimthi ka kapërcyer përroin dhe ka shpëtuar. I prekur nga kjo ngjarje dhe instinkti i kaprollit për të shpëtuar jetën, pashai ka ndërtuar këtë urë e cila ekziston sot e kësaj dite.

Po të ekzistonin sot ato ura të shkatërruara, me bukurinë dhe atraktivitetin që kishin, do tia kthenin imazhin e merituar Dibrës së Madhe.

NË QYTETIN KU U NGRIT SHTATORJA MË E RE E SKËNDERBEUT

Shtatorja paraqet një Skënderbe, një djalë të ri, që sapo ka mbërritur në Dibër, pasi braktisi frontin e Nishit, një Gjergj Kastriot, që po përshëndetej me vëllezërit e tij dhe po i ftonte për të nisur betejat madhore, që historia tashmë i ka gdhendur në çdo gur e mal të këtyre trojeve të lashta shqiptare.


Foto: Bujar Karoshi

reportazh

Urimet vinin nga të gjitha anët. Të njohur e të panjohur, dibranë e të tjerë nga vise të ndryshme i jepnin dorën dhe e uronin me gjithë zemër. Donin ta njihnin Zaimin, skulptorin, arkitektin. Atë natë bulevardi i Peshkopisë ishte mbushur si kurrë ndonjëherë...

Skënderbeu mes dibranëve

Nga: **NAIM PLAKU**

Dita sot duket më ndryshe. Mëngjesi është më i freskët. Qielli krejt i pastër shkëlqen në tërë horizontin. Natyra qesh e toka gëzon. Të udhëtosh në një ditë të tillë të veçantë drejt vendlindjes për ngjarje të gëzuar, ndjen një kënaqësi të veçantë. Aq më tepër të jesh në këtë udhëtim me Zaim Korsin, me këtë burrë plot forcë e energji, plot pasion për artin e plot dashuri për vendlindjen, i përkushtuar tërë jetën për t'i dhënë asaj aq shumë nga djersa, mendja dhe mundi i tij, me këtë njeri të imët, por madhështor, të thjeshtë e punëtor, bujar e besnik i idealeve të çmuara kombëtare, është vërtet një kënaqësi e veçantë.

I kam ndjekur prej tre vitesh përpjekjet e vazhdueshme për të realizuar ëndrrën e të tij të madhe, për të ngritur një shtatore të Skënderbeut e për ta vendosur në vendlindjen e tij. Kam admiruar këmbënguljen dhe pasionin e tij që të përjetësojë në bronz historinë më të ndritur të shqiptarëve. Ndaj dhe udhëtimi me të, në këto ditë qershori, kishte vlera të veçanta, ndillte të tilla frymëzime e kënaqësi që s'i kisha provuar asnjëherë

- Kam ëndërruar tërë jetën të bëja diçka për kryetrimin e Shqipërisë, për themeluesin e shtetit të parë modern shqiptar. – më thoshte një ditë.

Dhe para dy vitesh ia nisi punës. Mori mendimin e njerëzve të artit e kulturës, të historianëve më të mirë që kishin shkruar për Skënderbeun. Zgjodhi skulptorin e talentuar Sadik Spahija që do të realizonte këtë vepër, tërhoqi mendimin e shumë specialistëve dhe të njerëzve të thjeshtë. Në studion e piktorit po merrte jetë shtatorja nga dita në ditë. Herë prishej e herë ndryshoheshin bocetet që na paraqiste skulptori. Dëgjonte me kujdes çdo mendim. Thirrte në studion e tij skulptorët më të mirë, piktorë, historianë, njerëz të thjeshtë dhe i dëgjonte me kujdes vërejtjet e tyre, deri sa u kristalizua mendimi, u qartësua figura monumentale, pas një sërë diskutimesh për të paraqitur një Skënderbe, një djalë të ri, që sapo kishte mbërritur në Dibër, pasi braktisi frontin e Nishit, një Gjergj Kastriot, që po përshëndetej me vëllezërit e tij dhe po i ftonte për të nisur betejat madhore, që historia tashmë i ka gdhendur në çdo gur e mal të këtyre trojeve të lashta shqiptare.


Foto: Bujar Karoshi


Foto: Bujar Karoshi


Foto: Bujar Karoshi

Kryetarja e Kuvendit, Znj. Jozefina Topalli dhe kryetari i Bashkisë së Peshkopisë, Z. Ilir Krosi, duke zbuluar shtatoren e Skënderbeut

Kryetari i Bashkisë së Peshkopisë, Z. Ilir Krosi, duke i dhënë titullin "Mirënjohje e qytetit të Peshkopisë" sponsorit të shtatores së Skënderbeu, z. Zaim Korsi

Sa herë kam menduar me vete! Ku e gjen këtë forcë ky djalë, ky burrë për të përmbushur dëshirën e madhe të krejt dibranëve?! Ç'pasion dhe energji të pashtershme vlojnë në gjirin e tij, çfarë përpjekjesh bën, shpeshherë jashtë mundësive të tij fizike, për udhëtuar e shkelur vend më vend, për t'u ngjitur më mal, për t'u takuar me këdo për të tërhequr mendimin më të specializuar! Unë do ta quaja pa mëdyshje një hero. Për mua është një hero i vërtetë që sakrifikon çdo gjë për të lartësuar në vendlindjen e tij përmendoren e kryetrimit, e Heroit tonë kombëtar.

Më vjen ndërmend një ditë, që, pasi u përcaktua vendi ku do të vendosej shtatorja, duhej gjetur një bllok mermeri nga ata që ka Dibra, që do të shërbente si bazament për vendosjen e shtatores. Së bashku me skulptorin shkuam në Zogjaj, atje ku ishte miniera e mermerit dhe u ngjitëm malit duke prekur e matur çdo gur, gjersa vendosëm dhe i vumë shenjë atij blloku të madh mermeri, mbi të cilin sot lartësohet mbi katër metër shtatorja. Zaimi pastaj gjeti arkitektin Ilir Cici dhe vendosën përfundimisht për ambientin ku do të vendosej monumenti që të krijonte një harmoni me mjedisin. Përfundimisht u përcaktua vendi që shtatorja të ngrihej para Pallatit të Kulturës së qytetit të Peshkopisë.

NËPËR LUGINËN KU GJËMON HISTORIA

- Do të shkojmë nga Qafë -Thana. – na tha Zaimi duke qeshur atë mëngjes. - Do të zbresim nga Struga në Dibër të Madhe, luginës nga kaloi Skënderbeu, kur erdhi nga Nishi. Këtej ka kaluar dhe një javë më parë, tashmë i derdhur në bronz në një nga fonderitë më të specializuar për të tilla punë në Bullgari. Na ka ndihmuar fort skulptori nga Gostivari, Xhelil Rufati.

Bruna, vajza që udhëtonte së bashku me ne dhe që do ta kishim konferenciere në paraqitjen e montazhit muziko-letrar të ditës së përurimit të veprës së bashku me gazetarin e njohur Dëfrim Methasani, ishte e mbushur plot emocione. Kur kaluam Strugën dhe po rrëshqisnim tatëpjetë luginës së Drinit, tha:

- Sa mirë për mua! E para herë që po kaloj nëpër këto vende. Sa bukur! Ndjej vërtet një mall që s'e kam provuar kurrë.

Dhe filloi të pyeste, për vendet, për malet, për fshatrat, për qendrat e banuara. Të gjitha i përkisnin trevës së Dibrës, një trupi, një emri, një gjuhe e një gjaku, një të kaluare të përbashkët, një historie që na ndau padrejtësisht e na mban të ndarë prej më se një shekulli. Këta troje pesë

reportazh



Foto: Bujar Karoshi

shekuj më parë i bashkoi Skënderbeu, i bëri një që nga Kavalla e largët e gjer në Ulqin e Dardani.

Zaimi filloi t'i shpjegonte disa nga vendet ku ishte ngulitur historia e Kombit.

- Kemi lënë prapa Ohrinë nga hyri Skënderbeu. Ja, përtej, në të djathtë të Strugës është Mokra, ku në tetor 1445 u zhvillua një ndër të parat beteja madhore ku shkëlqeu lavdia shqiptare.

Kalojmë Strugën, por gjithkund na shfaqen gjurmët e asaj historie që na bën vërtet krenar. Në të majtë të Drinit, brenda kufirit tonë shtetëror, është Modrica dhe pak përtej, ku sot ngrihet një digë hidrocentrali, është Koxhaxhiku, ose kalaja e përmendur e Sfetigradit dhe përtej qytetit të Dibrës është Oraniku, ku u zhvillua beteja tjetër e famshme më 1447. Nga mali i Kërçinit zbret Radika. Përtej saj ndodhet Gostivari, fusha e Pollogut, ku u zhvillua beteja më 22 prill 1455. Më përtej akoma kemi Mokrën e Shkupit ku u zhvilluan tri betejat madhore të kurorëzuara me fitoren e Skënderbeut (1445, 1446, 1459).

Ndalemi në Dibër pak para se të mbërrijmë në Bllatë. Hedhim shikimin majtas e djathtas, këndej e andej Drinit. Vërtet këtu flet historia, gjëmon historia. Zëri i saj duket se del nga thellësitë e tokës, e përcjellin valët e Drinit, për të jehojnë bjeshkët, këndojnë e krenohen malet. Pëllëmbë e gjak, pëllëmbë e histori ka ky vend. Prandaj, ndoshta, shkruante Feti Pasha në atë kohë, një armiku ynë, që e vlerësonte kaq shumë Dibrën: "..përfundimi i luftimeve tona varej gjithmonë nga sundimi në të Nëntë Malet e dy Dibrave. Atje është zemra e Shqipërisë. Porta e vërtetë e Shqipërisë është atje. Kurdoherë"...

Përtej lumit është Fushë- Bulqiza, Ura e Qytetit prej nga kalonte Rruga e Arbërit që sot po hapet për t'i shërbyer kësaj treve. Ja, Gurët e Skënderbeut, Vajkali ku u kurorëzua me fitore beteja kundër hordhive turke të komanduara nga tradhtari Ballaban Pasha. Ja dhe Shupenza e Moisiut!

Dhe ecim, ecim...Hyjmë në fushën e Maqellarës. Matanë është kalaja e Kërçishtit, e Obokut, të gjitha këta kala lidhen me emrin e kryetrimit. Atje, përtej Drinit, sipër mbi majat e maleve, në Qafë-Murrë kemi kalanë e Stelushit. Kalojmë Maqellarën dhe na shfaqet kalaja e famshme e Grazhdanit, mu buzë rrugës, me ata muret e gjëra që diku-diku janë ruajtur të paprishura ende në themele nga erozioni shumëshekullor. Këtu është dhe vendlindja e mikut tonë, Zaim Korsit. Pastaj Dovolani, Qenoku dhe, ja, tek shfaqet Peshkopia.

NË PRAG TË NJË FESTE POPULLORE

Qytetin e Peshkopisë e gjetëm në prag feste. Bulevardi i bukur me blirët e famshëm në dy anët e trotuareve, kundërmonte i tëri. Grupe-grupe mblidheshin burra e gra, të rinj e të reja, nxënës e fëmijë rreth monumentit të mbuluar me një beze kuq e zi në prag të përurimit. Disa punëtorë po i jepnin dorën e fundit dekorit prapa dhe lulishtes përpara. Flamuj kombëtarë valëviteshin në dy anët e shtitores "Elez Isufi". Banderola, parulla, afishe zbukuronin vendin. Në ballë të Pallatit binte në sy një parullë e madhe: "Mirë se erdhe në vendlindje"! Fytyra gazmore, qytetarë kureshtarë, malësorë që kishin zbritur nga katundet e tërë Dibrës, shikoje në pragun e kësaj feste populllore.

- Punë të mbarë, burra!- i përshëndeti Zaimi punëtorët që po i jepnin dorën e fundit brodurës prapa me një lulishte të bukur përpara që rrethonte monumentin.

- Faleminderit për këtë dhuratë që na solle! Të përgëzojmë dhe të uron gjithë Dibra. Të lumtë! Rrofsh!

Urimet vinin nga të gjitha anët. Të njohur e të panjohur, dibranë e të tjerë nga vise të ndryshme i jepnin dorën dhe e uronin me gjithë zemër. Donin ta njihnin Zaimin, skulptorin, arkitektin. Atë natë bulevardi i Peshkopisë ishte mbushur si kurrë ndonjëherë. Kishin ardhur nga Kosova e Maqedonia. Kishin mbërritur artistë të mëdhenj si Mirush Kabashi, Ilir Shaqiri, Kastriot Tusha e Manjola Nallbani, Qerim Sula, Vera Laçi e plot të tjerë. Përshëndetje. Urime. Nga megafonat përhapeshin vargjet e këngës:

Puthe birin, nanë, jepi uratën
Hajde, Gjergj, përveshe shpatën
Se kta troje e ky dhe
E kanë emrin Skënderbe...

Kishin ardhur dhe plot gazetarë të medias së shkruar e vizive. Gazetarë nga Kosova e Maqedonia, të BBC-së, historianë e shkrimtarë. Kishte ardhur dhe mikja e shqiptarëve nga Anglia Patricia Nuxhi, e cila kishte hapur një ekspozitë të veçantë me një seri librash për Skënderbeun të shkruara në gjuhë të ndryshme nga autorë të huaj. Ishte një ekspozitë e rrallë, që një angleze, e shtyrë nga madhështia e figurës së heroit, kishte mundur të grumbullojë ndër vite dhe t'ia sjellë Dibrës në këtë ngjarje të shënuar. Kishte ardhur skulptori Sadik Spahija, autori i shtatores, skulptorë të tjerë, shokë e miq të tij për të nderuar autorin.

DRINIT PLAK I KËNDOJNË VALËT

Vërtet na dukej se dhe Korabi qeshte e gëzonte. Dhe Drinit plak i këndonin valët atë ditë. Dielli e nxori shpejt syrin mbi mal e rrezet e para të tij prekën shtatoren e Heroit. Pallati i Kulturës kishte përgatitur një program tematik dinjitoz. Artistët dibranë atë ditë ishin të gjithë në lëvizje, por dhe në ankth, sepse kishin gjithë peshën e këtij organizimi. Po kështu dhe kryetari i bashkisë, z. Ilir Krosi, lëvizte gjithë shqetësim, priste mysafirët e nderuar, u uronte mirëseardhjen dhe u servirte në çdo moment mikpritjen dibrane.

Dalëngadalë bulevardi po mbushej. Andej këndej jepeshin intervista, bisedohej, pyetej, takoheshin e lidheshin duar, përqafime vëllazërore, njohje të reja, prezantime. Gjithçka e bukur, e këndshme, madhështore. Dhe kush e bënte këtë? Kush i kishte mbledhur gjithë këta? Nga vinte gjithë ky shkëlqim, nga buronte gjithë kjo dritë? Përse rrihnin fort zemrat e çdonjërit? Kush i bashkonte e përse e ndjente veten krenar gjithkush? Ishte ai që kishim përpara, ai që bashkoi kombin, ai që krijoi shtetin e parë shqiptar. Ishte ai Burri i Dheut, që dërrmoi ushtrinë më të fuqishme të kohës, që mposhti Sulltanët më të egër të Turqisë, që për 25 vjet me radhë korri fitoret më madhështore në krye të një ushtrie të vogël, kundra një ushtrie të fuqishme e më moderne të kohës, që kishte pushtuar gjysmën e botës. Përpara nesh ishte simboli i lirisë shqiptare, Heroi i Kombit, shtatlartë, fisnik e madhështor,"shtatorja e gjallë e Marsit", siç do ta quante Noli.

Kishin zbritur që në orët e para të mëngjesit malësorë kësulëbardhë nga Sina e gjyshërve të tij, nga Gjergjishtja e Shashari, nga Lura ku farkëtoheshin armët e tij, nga kalatë legjendare ku u kalit lavdia, nga Qidhna krenare e heroizmave që u la sa e sa herë me gjak trimash, nga Bresti i Pjetër Shinit dhe Kuket e Pal Kukës, nga vendlindja e tij, Kastrioti, ku dhe sot qëndrojnë në këmbë kullat e Gjonit, të Panës e të Gjinit, nga Gryka e Nokës që mbushi Setën e kulluar vite me rradhë me gjak armiku, nga Blliçet, nga Reçi e Dardha, nga Kalaja e Dodës e Sllova, nga Lura e gjithandej Dibrës së Madhe e Dibrës së Vogël, që në ato vite të stuhishme qenë kurdoherë në krahë të Heroit.

Erdhi dhe çasti i shumëpritur. Kryetarja e Kuvendit, z, Jozefina Topalli, kryetari i Bashkisë dhe sponsori Zaim Korsi zbuluan shtatoren. Duartrokitje. Brohoritje. Sytë e të gjithëve tashmë ishin ngulur në një vend. Në krah të tyre qëndronte skulptori Sadik Spahija, ai që kishte derdhur talentin dhe mjeshtërinë e tij për t'ju dhënë dibranëve një Skënderbe dibran, që sot në shenjë nderimi për ta ka hequr nga koka përkrenaren, ka shpalosur krahun e fuqishëm dhe po i përshëndet e po i fton për të nisur misionin e madh: bashkimin e gjithë shqiptarëve nën hijen e flamurit kuqezi, besëlidhjen për qëndresë e luftë çlirimtare, betimin e madh për të mos i lënë këto troje nën këmbët e të huajve. Ishte ky mision që frymëzoi shqiptarët shekuj me radhë dhe na frymëzon e do të na frymëzojë përjetë, që ky vend, këta troje e ky dhe, të ketë në ballë flamurin Skënderbe.

Programi u hap me këngën "**Prina, Gjergj, se na ke ne"** e do të vazhdonte si një montazh muziko letrar me recitimin e Mirush Kabashit **"Porosia e fundit e Skënerbeut ditën që vdiq",** me përshëndetjen e pinjollit të Kastriotëve nga Italia Aleksandër Kastriota Skënderbeu, me shpalljen "**Qytetar nderi"** të qytetit të Peshkopisë, historianin Kristo Frashëri dhe me fjalët përshëndetëse të tij te regjistruar në pamundësi për të marrë pjesë, me fjalën e Ilir Krosit, kryetarit të Bashkisë dhe të Zaim Korsit, etj. Një ceremoni mjaft e bukur, që rrodhi aq natyrshëm.

E pashë të përlotur, tepër të emocionuar përkrah Sadikut dhe miqve të ti të shumtë. E pashë së bashku me familjen e tij. Të gjithë e kishin rrethuar me dashuri, me respekt, me mirënjohje. Ndjeva dhe unë krenari, gëzim, mallëngjim. Kur njeriu bën diçka për vendin e tij, kur le pas një vepër të bukur, kur merr me vete urimet dhe mirënjohjen e një populli të tërë, është vërtet një kënaqësi, një krenari legjitimi, që të bën të përjetshëm.

Në kthim na shoqëronte refreni i këngës: **" A po e njeh Evropë shqiptarin..."?!**

Peshkopi, 9 qershor 2009





Fotot: Bujar Karoshi

E pashë të përlotur, tepër të emocionuar përkrah Sadikut dhe miqve të ti të shumtë. E pashë së bashku me familjen e tij. Kur njeriu bën diçka për vendin e tij, kur le pas një vepër të bukur, kur merr me vete urimet dhe mirënjohjen e një populli të tërë, është vërtet një kënaqësi...

"Me këtë studim shkrimtari dhe studiuesi Xhafer Martini ka bërë jo vetëm detyrën e tij si intelektual, nga më të spikaturit e letërisë dhe folklorit, por edhe si dibran i mirë dhe stërnip i Kastriotëve"

Një stërnip i Kastriotëve përballet me optikën e Schmitt-it për Skënderbeun

Nga: **SAKIP CAMI**

Botimi "Skënderbeu" i historianit zvicerian Oliver Jens Schmitt, mbrojtës i teorisë së çmitizimeve, duhet thënë që në fillim që na acaroi për ndërmarrjen e tij dhe trajtimin joshkencor dhe të qëllimshëm të tij.

Mendja më shkoi menjëherë tek heroi zvicerian Vilhem Tel, një figurë e ngritur nga hiçi, për të patur një figurë legjendare. Dhe mirë kanë bërë, por le të çmitizojnë heroin e tyre dhe të mos merren me heroin tonë kombëtar dhe mbrojtësin e krishtërimit shqiptar dhe të Europës, në një kohë kur kjo figurë nuk është as mit dhe as legjendë, por një realitet i shekullit të 15.

Por prapë them bëri mirë Schmitt që na e freskoi edhe një herë kujtesën kombëtare dhe na bërë më kombëtar se ishim në të vërtetë, të harruar pas politikës dhe halleve të sotme njerëzore. Mirë bëri edhe A.Klosi që e përktheu sepse po të mos e përkthente Klosi do ta përkthente ndonjëtjetër dhe aq më keq nëqoftëse nuk e përkthente askush në shqip, libri do të bëntë xhiron e botës në të gjitha gjuhët e botës por vetëm në shqip jo. Dhe ne do të lëviznim si shurdhë, pa ditur se çfarë çorbe ishte gatuar dhe po gatuhej kundër nesh, kundër historisë sonë.

Për hir të së vërtetës ka patur shumë reagime nga historianë dhe shkrimtarë shqiptarë si nga Prof. Kristo Frashëri, nga Kadareja dhe Godo si dhe nga politika shqiptare e sotme kudo.

Unë dëshiroj të analizoj kritikën e një stërnipi të Kastriotëve, shkrimtarit dhe studiuesit të mirënjohur Xhafer Martini. A ka më mirë se kur reagon i zoti i shtëpisë, stopani i vërtetë. Kur prek në dinjitet dhe në nder nuk ka kohë të reja dhe kohë të vjetra. Edhe shekulli 15 duket sikur është viti 2008. Tek Skënderbeu nuk durojnë shqiptarët dhe aq më tepër dibranët që e kanë birin e tyre. Krutanët e kanë qytetarin e tyre, vlonjatët e kanë dhëndrin e tyre, tetovarët e kanë nipin e tyre. Tërë shqiptarët kudo që ndodhen e kanë nderin dhe krenarinë e tyre.

Por desha ti kujtoj historianit Schmitt se shpata është akoma afër Zvicrës, në muzeun e Vienës sepse Austria ja njeh meritat për mbrojtjen e krishtërimit, Hungaria ja njeh aleancën me Huniadin, Venediku ja njeh mjeshtërinë e luftës dhe të diplomacisë, Turqia e ka provuar mbi ushtarët e saj, forcën dhe mjeshtërinë luftarake të Skënderbeut.

Shkrimtari i mirënjohur dhe studiuesi i kanunit të Dibrës dhe kanunit të Skënderbeut Xhafer Martini, bash nga ai vend ku ka lindur dhe është rritur Gjon Kastrioti, (Gjoni dhe jo Ivani) e ndjeu për detyrë të reagonte dhe ti kundërvihej Schmitt-it për këtë libër me gabime të theksuara shkencore.

Martini, tashmë i myslimanizuar prej kohës, por me mbiemër katolik që simbolizon pushkën, këtë rradhë është armatosur me faktet e mbledhura në literaturë dhe në zonën e vet ku akoma janë reliket dhe rrënojat sepse shekulli 15 është shumë afër për një komb që e don dhe e mbron fort historinë e tij të lavdishme.

Që në fillim lexuesi shokohet me guximin e Schmitt-it që e quan Gjonin Ivan dhe përpiqet ta konsiderojë sllav duke u justifikuar se në atë kohë nuk ka patur kufij dhe etnitete si sot. E pranon që Skënderbeu është nga Sina e Dibrës por i heq përkatësinë katolike të kohës dhe e quan ortodoks, gjë në fakt nuk është e vërtetë. Atëhere përse në Dibër është trashëguar mbiemri Gjoni dhe jo Ivani, përse shumica e mbiemrave të sotëm në Dibër janë katolikë si Lleshi, Leka, Marku, Gjoni, Gjoka, Martini etj. Trashëgimi mbi boshllëk nuk ka.



Martini sqaron se edhe nëna e Skënderbeut, Vojsava është nga fisi Tribaldi, (fis ilir) nga Tetova, nga pjesa shqiptare e saj, (Fusha e Pollogut).

Autori i kësaj kritike sqaron edhe trojet e Kastriotëve që përfshijnë Dibrën, Matin, Krujën etj. Askush nuk e mohon praninë e fiseve të tjera të fuqishme si Muzakajt, Topiajt, Balshajt etj por roli i Skënderbeut dalloi mbi të tjerët sepse diti si një prijës i përgatitur të organizonte dhe fitonte 24 beteja të mëdha kundër Turqisë së asaj kohe që ishte në kulmin e vet.

Motivet e luftrave të Skënderbeut, vijon Martini, autori i kësaj kritike, nuk janë hakmarrje personale por për mbrojtjen kombëtare sepse të gjithë ne që jemi shqiptarë e dimë se çdo të thotë pushtim dhe se shqiptari nuk duron njeri mbi krye të vet.

Përpjekjet e Skënderbeut vazhdojnë me Kuvendin e Beslidhjes së Lezhës për bashkimin e shqiptarëve, për bashkimin e fiseve shqiptare dhe kjo është një tjetër meritë e Skënderbeut për kohën. Kështu në atë kohë ne kishin një shtet shqiptar me një kryeqendër, Krujën dhe kjo nuk ishte pak.

Autori Xhafer Martini ndalet gjatë në toponimet e zonës së Çidhnës ku janë edhe gjurmët reale të vendbanimit të Kastriotëve.

Skënderbeu nuk u harrua asnjëherë në asnjë koihë dhe në asnjë rrethanë. Shkruajtën bashkëkohësit e tij shqiptarë dhe të huaj,

> Autori i kësaj kritike sqaron edhe trojet e Kastriotëve që përfshijnë Dibrën, Matin, Krujën etj. Askush nuk e mohon praninë e fiseve të tjera të fuqishme si Muzakajt, Topiajt, Balshajt etj por roli i Skënderbeut dalloi mbi të tjerët sepse diti si një prijës i përgatitur të organizonte dhe fitonte 24 beteja të mëdha kundër Turqisë së asaj kohe që ishte në kulmin e vet.

veçanërisht i madhi Marin Barleti bashkëkohës i Skënderbeut, u shkruan mijëra vepra, u pikturuan qindra portrete të tij. Janë me dhjetra këngët, legjendat dhe gojëdhënat popullore për Skënderbeun. Të panumërta janë toponimet. Dibra duke qenë vend i origjinës së Kastriotëve, shkruan Martini, është pëllëmbë e toponime për Skënderbeun. Ato janjë me qindra, por ne po japim vetëm për ato që ndodhen në Sinë, se po të bëhej kjo për gjithë Çidhnën e për gjithë Dibrën do të duhej një libër voluminoz shumë vëllimësh.

Toponimi **Kishat**, sepse ka patur 5 kisha në kohën e Skënderbeut, çka dëshmon edhe për numrin e madh të popullsisë që kishte dhe për nevojat e saj për kulte.

Sina mund të konsiderohet si ballkon i maleve Përëndimore të Dibrës (Valit, Rujës dhe Gjergjishtës), vend jo vetëm i bukur dhe i mbrojtur, por edhe shumë prodhues.

Gështenja e Matrisëve, është një gështenjë e madhe me degë të hapura anash nën hijen e të cilës mund të rrinë lirisht njëqind e ca burra. Trungu i saj është i trashë. Ndodhet në bahçen e Selim Kaloshit. Këtu nën hijen e kësaj gështenje, burrat mblidheshin në kuvende të ndryshme. Thonë se nën hijen e kësaj gështenje është ulur dhe ka biseduar me burrat e vendlindjes së tij Skënderbeu. (Faqe 84)

Varret e Xhipve. Xhipët mbathnin kuajt e ushtrisë së Skënderbeut.

Bunari (Pusi) i Skënderbeut ka qenë hapur në qytetin e Skënderbeut.

Zabeli i Gjinit. Gjini ka qenë paraardhësi i Kastriotëve.

Zabeli i Gjonit, babait të Gjergj Kastriotit, Skënderbeut.

Kepi i Skënderbeut, pranë lumit Seta.

Pazari i Skënder beut

Lama e Skënderbeut etj (Nga faqja 84-87)

Libri vazhdon edhe me shumë toponime të tjera, por kryesore është fakti se këtu ka egzistuar një qytet i plotë me të gjithë përbërësit e tij, pra ka patur një qytetërim mesjetar, gjurmët e të cilit janë në zhdukje.


Në përfundim thekson studiuesi Martini, Skënderbeu është një personazh historik, aspak mitik megjithë dashurinë shekullore të shqiptarëve për ta imituar dhe ngritur në legjendë.

Me këtë studim shkrimtari dhe studiuesi Xhafer Martini ka bërë jo vetëm detyrën e tij si intelektual, nga më të spikaturit e letërisë dhe folklorit, por edhe si dibran i mirë dhe stërnip i Kastriotëve.

Këto ditë u vendos në qytetin e Peshkopisë shtatorja e Skënderbeut. Le ti verbojë ata që nuk e duan dhe që duan ta mohojnë. Ne do ta ngremë edhe më lart jo vetëm në Peshkopi, Dibër, Mat, Krujë, Tiranë, Prishtinë, Shkup, por edhe në kryeqytetet europiane, të cilat ai i mbrojti me luftërat e tij.

Një gazetar nga Kurbini shkruan për Dibrën

Dibra, pëllëmbë dhe histori. Kështu hapet ky libër që i kushtohet fisit Cami në Dibër, një nga fiset dhe familjet e mëdha të Dibrës të njohura dhe jashtë saj.



Vetëm në Kongresin e Dibrës më korrik 1909 nga ky fis morën pjesë tre delegatë, Dan Agë Cami, Eqerem Agë Cami dhe Hamit Agë Cami

Historia e këtij fshati dhe këtij fisi që ka më shumë dëshmorë për liri, përparim dhe pavarësi se sa shtëpi është pasqyruar edhe në disa libra të tjerë, por ky libër i shkurtër publicistik dhe biografik ka një këndvështrim tjetër dhe tingëllon aktual për kushtet që jetojmë, sepse shtrihet në kohën e sotme dhe pasqyron figurat e reja të këtij fshati dhe këtij fisi. Nga ky fis kanë dalë luftëtarë për liri dhe pavarësi, mësues dhe përhapës të shkollave të para shqipe, deputetë, ministra etj.

Autori Bektash Zeneli duke njohur nga afër një nga bijtë e fisit Cami, Shpëtimin, mësues, veprimtar politik, intelektual dhe publicist në Kurbin, tani në Tiranë, ka marrë nismën dhe ka shkruar këtë monografi, e veçantë në llojin e saj.

Tek Shpëtimi ai nënvizon karakterin e tij të qëndrueshëm, cilësitë e tij të trashëguara dhe të kalitura si besën, bujarinë, punën, aftësitë drejtuese e menaxhuese si dhe talentin e tij.

Për t'i ilustruar këto cilësi mund të përmendim vetëm faktin se Shpëtimi është ideatori dhe realizuesi i patentës së parë shqiptare elektronike të standartit europian, me vetëm tetëqind mijë dollarë, duke realizuar një dokument me elementë sigurie edhe më të sigurtë se vendet europiane.

Intelektuali Shpëtim Cami spikat gjithashtu edhe për një veçori tjetër: është prezantuar në publik edhe si njeri i letrave, veçori që e rrit dimensionin e figurës së tij edhe si intelektual i kompletuar. Ai ka dituar me mjeshtëri të gjejë kohën e të hedhë në letër përpjekjet e njerëzve, punën e tyre, pasqyron rezultate, ngre probleme, sugjeron rrugëzgjidhje.

Kjo duket në të gjithë librat e tij e sidomos në librin e tij të fundit :"Njerëz dhe realitete".

Mëhill Ndrepepaj duke folur për këtë libër thotë për Shpëtimin se ai është nga ata intelektualë dhe drejtues që ecën përpara, por duke qëndruar gjithmonë zgjuar.

Ne me të drejtë krenohemi me dibranë të tillë por më shumë duhet të krenohet vetë Dibra që i ka lindur, rritur dhe edukuar me vlerat më të bukura që mbart qenja njerëzore. Ndaj dhe ne dibranët duhet t'i jemi mirënjohës një kurbinasi të mirë që shkruan dhe flet bukur për djemtë e Dibrës ashtu siç ia ndjen zemra. Ndaj jo vetëm urim i im por i të gjithëve dibranëve kudo që ndodhen sot është: Të këndoftë në duar pena gjithmonë, o Bektash Zeneli.Kështu shkruaj gjithmonë për punën, jetën e njerëzit!

SHAQIR SKARRA

histori

Shqiptari është malësor, është krijuar për të jetuar në viset tona, nuk mund të jetojë as në Jemen, as në Siberi.Pra iu lutëm vëllazërve tonë këtë pikë ta marrin para sysh dhe t'i shkruhet ministrisë së luftës që për këtë çështje të bëhet një rregullore e posaçme.

Kongresi i Dibrës dhe Hafiz Ali Korça

Shkruar nga Abdyl Ypi në vitin 1918

(Vijon nga numri i kaluar)

MBLEDHJA E KATËRT E KONGRESIT.

Në këtë mbledhje prapë Z.Hafiz Ali Korça mori fjalë dyke thënë:

-Shumica e djemve Shqiptarë po e lenë stelen nëpër shkretëtirat e zjarrta të Jemenit, për shëmbull, parvjet prej Korçe shkuan dy taborrë në Jemen.Vetëm 16 veta u kthyen dhe ato pas pak vdiqën.Shqiptari është malësor, është krijuar për të jetuar në viset tona, nuk mund të jetojë as në Jemen, as në Siberi.Pra iu lutëm vëllazërve tonë këtë pikë ta marrin para sysh dhe t'i shkruhet ministrisë së luftës që për këtë çështje të bëhet një rregullore e posaçme. Ky propozim zjeu mjaft më së fundi me vota të plota u vendos që të shënohet një nyjë e veçantë dhe të merren masat e duhura.. Përsëri Zoti Hafëz Ali:

- Kemi dhe një punë me randësi që në qoftë se nuk i kemi venë veshin dëmet do t'i kemi aqë të mëdha sa shrimi do të jetë i pamundur. Të gjithë me një gojë c'është? Z.e tij tha: - Gjer 50 a 60 vjet më parë nëpër gjith vilajetët e turqisë medresetë kanë qënë si nga faqylte me vehte. Që prej ditës që filluan të çelen universitete, medredetë vleftën e pare nisën ta humbin. Për vërtetimin e ksaj fjale mjafton kjo shëmbëll: prej medreseve të vjetra nuk delnin vetëm muderrizë dhe muftinj, porse dhe mjeksit, barndëtonjësit ,inxhinierët, oficerët, gjith nëpunësit politikan të mëdhenj e të vogjël andej delnin. Një shekull më parë vetëm në Stamboll ndodheshin më tepër se shtatëdhjet mijë nxënësa. Dua të mos



largohem e të mos futem në mbretëritë e vjetra muslimane,por vetëm në Turqi po të hedhim sytë pak, do të gjejm me mijra njerës të mbaruar në ç'do farë diturije, disa prej syresh: Gjuraniu, Fenariu, Husrevi, Ebu_ssu_udi, Ibni Qemali, Birgjeviu, Gjelenbeviu e të tjerë. Që moti nëpër medredet s'këndohej vetëm grameri e sindaksa, llogjika e vetëm fikh (dituri feje) ,por këndohej fizikë,kimi,dituri natyre, matematik, anatomi, (Teshrih) dfilozofi, Alxhebrë e tj.Por sot? Për ditën e zezë!. Burrat që delnin prej medreseve të para mësonin disa gjuhë me shkrim e me këndim aqë sa kur e donte nëvoja.Ulemat e parë mbanin edhe diskure në gjuhët arabisht e persisht e ndryshe.Sot për fat të keq, kalben njëzet vjet nëpër medresetë dhe le që nuk janë të zotët të fjalosen si bijt e arebëve por nuk mundin as të këndojnë lehtësisht e të kuptojnë çdo libre arabisht.A kshtu duhet me qenë?Një nxënës që merr diplomë prej një medreseje përse të mos jetë i zoti të shkruaj e të kuvendojë arabisht si lipset? Përse një dipllomëmarrës të mos këndojë sot çdo libër arabisht?

MBLEDHJA E PESTË E KONGRESIT.

Z.Riza Shkodra: Shokët që kemi jashtë, katër nyjavet as gja s'pranojnë, s'kemi të drejtë të bisedojmë, kush thoshte:

Z. Halim Tetova: "me çshkronja do të këndojme."

Z.Hafiz Ali: "Zoti Halim! Të lutem shkronjat t'i lamë pas qejfit të sikujt."

Z.Sadik Pasha: "mjafton Turqishtja."

Z.Hafiz Ali: "Pasha më vjen keq për Z.tuaj se atëherë vendi i juaj do të quhet Greqi"

Z. Qenan: " Më duket se çështja e shkronjave mori fund"

Z. Mustafa Arifi: " Zotërinj! Si po e shoh un kundërshtimi rrjeth nëpër degët se sa për themelin nuk po shoh as pakë kundërshtim. Lutem t'i jepet funt.

Kryetari Z.Mufti Dibra: "Ta vemë në vota". U vu dhe me shumicë u pranua.

MBLEDHJA E GJASHTE E KONGRESIT

Muderris Mustafa Ohrija dha nje memorandum me nj'a dhjetë firma që thoshte në qoftë se bisedohen të tjera sende jashtë tekstit të nyjevet themelore na do të ikim. Krisi një tallje brenda në mbledhjet, udh e mbarë iu qoftë . U dha vendimi i prerë përgjithësisht që sot Kongresi do të marrë fund. U këndua raporti i z.Doktor Temos me njëzet, tridhjetë firma. Thoshte : Shqipëtarët jane mbrojtësit e konstutisionit, qeverisë Turke i janë përunjur.

Duke qenë se prej ngjarjes 31 Marsit e këtej do një levizje s'është dukur as pak, për fat të keq, po marrin vesh se disa nga të mëdhenjtë politikanë turq në hakët të shqipëtarëve ushqejnë disa mendime të ndryshçme. Pra dëshirojmë që të formohet një komision nga shqipëtarët liridashës e kesisoj të ngrihet ky dyshim.

Përmi këtë, fjala u zgjat e u shtri tepër së fundi s'u pranua.

U këndua raporti i Z. Jusuf Bej, që kallëzonte besë lidhjen e malësorëve që të mos vidhnin e do te mos vriteshin. U shënua në proces –verbal si ishte. U këndua raporit i zoti Mutesin që fliste përmbi mënyrën e mirësimit të Vakfit. U këndua raporti i zotit Islam Verionit, që thoshte përmbi fuqin e kanunit tjetër fuqi s'ka, u pëlqye fort edhe u vendos të vihet nyja e parë prej nyjavet ndjekëse të nevojshme. U fol përmbi të dhjetat, kush tha të pranohet.

Z.Hafiz Ali: Fort të drejtë ka, se po të bëjmë hesap gjer më sot me qindra mijë burra trima si nga korëxhitë si nga kaçakçitë jane vrarë.

Z. Riza B. Shkodra: Mekat i madh! Po i mbyllim qeverisë mburim më të madh t'ardhjeve.

Z.Qenan: Çuditem mbi kundërshtimin e Z. Riza qysh po nemitet gjith rrethi i Kongresës?

Z. Mustafa Arifi: Ju lutem vëreni në votë të ngrihet kjo kucedër. Që si nga gjaja ashtu edhe nga shpirti po e grin e po e bren popullin.

Z.Riza: Unë me qenë se jam nënpunesi i rezhisë s'e pranoj. Mbi ket fjalë e sipër krisi një qeshje e natyrshme.

Z.Hafëz Ali: Dua një raport dyk e thënë se shumë njerëz shqiptarë nga çpifja se gjoja janë reaksonierë po dergjen nëpër burgjet lutem lirimin e tyre ta kërkojmë me telegraf prej visevet e larta e t'i shpëtojmë vllazrit tonë. Kjo çështje zjeu e buçiti shumë. Z. Halim , Z. Suhejl, Z. Qenan dhe ky shkrimtari bëmë fjalë mjaft, fundi u vendos dhe për lirimin e tyre e iu dha telegraf Mahmud Shevqet pashajt e tjerve.

Z. Andria Ballamçi: Dua një raport që tregonte besnikërinë të Vllehëve drejt mbretërisë Turke. U prit me një trokitje duarsh.

Z.Qenan: Për forcimin e vëllazërisë, moti që vjen të futim Edirnevë dhe të mblidhemi përsëri në një vend. Kush në Shkup, kush ne Shkodre e kush Manastir e gjetkë tepër u zgjat, u huth shorti i ra Kosovës.

Shënim: Këto material i solli për botim Neki Kaloshi

Dibër e Madhe- Kryetarët e komunave vizituan Francën

Përvoja drejt integrimit në BE

Kryetarët e komunave Dibër e madhe, Ohër, Strugë dhe Resnjë ditë më parë ishin në një vizitë pune në Francë në rajonin e Normandisë të organizuar nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale.

Siç na informoi Argëtim Fida, kryetar i Dibrës së Madhe, " qëllimi i kësaj vizite ishte që kryetarët e këtyre komunave të Maqedonisë të njihen më mënyrën e zhvillimit rajonal që realizohet në Francë. Me këtë rast u bënë edhe njoftimet e para ndërmjet komunave me probleme të ngjashme, më që pastaj të realizojnë edhe binjakëzimet mes tyre.

Gjatë qëndrimit në Normandi, shtoi Argëtim Fida, " unë si kryetar i Dibrës së Madhe qëndrova në komunen e Ifit që është komunë në kuadër të Kaenit, kryeqytet i Normandisë, qytet me histori të lashtë por edhe me aktivitete të shumta.

Ajo që ne na interesonte më shumë, theksoi Fida, " ishte mënyra e bashkëpunimit ndërkomunal që kryhej në kuadër të komunave të rajonit, kompetencat që i kishin ata në kuadër të sistemit të vetëqeverisjes lokale mbi bazat e Bashkësisë Evropiane drejt së cilës aspiron edhe Maqedonia. Që edhe ne si kryetarë të komunave, në Bashkësinë e Vetëqeverisjes Lokale të inicojmë hapat që Maqedonia t'i ketë para se të bëhet anëtare e BE-së".

Argëtim Fida, theksoi se, "Kaeni kishte dy universitete, ndërsa qyteti i Ifit që tashmë ishte bashkuar me Kaenin, kishte fakultetin e elektroteknikës dhe të informatikës, synim që dëshirojmë në të ardhmen ta realizojmë edhe ne me dispersimin e një ose dy fakulteteve të USHT-së në Dibër të Madhe. Atje u njohëm edhe me përvojën e tyre Pamë përvojën e tyre , se si ata i kanë shfrytëzuar tokat e shtetit, mënyrën e zhvillimit dhe të tërheqjes së investitorëve për zhvillimin e industrisë, që edhe ne të mund ta përdorim me rastin e marrjes për menaxhim të kazermës ushtarake në Dibër të Madhe".

Ky ishte një udhëtim I shkurtër por i ngjeshur, përplot me përvoja të dobishme, duke shkëmbyer edhe vizionet tona me nikoqirët, u shpreh Fida. Në muajin shtator, në delegacion nga Franca do ta vizitojë Shkupin dhe Ohrin, ku do të diskutojmë për letrat e interesit që do tu drejtohen këshillave komunale të komunave përkatëse për të parë edhe interesin për binjakëzim.

Dibra e Madhe, tha Fida, "është binjakëzuar me Llomin e Bullgarisë, që është anëtare e BE. Sipas legjislacionit të BE për të tërhequr fonde nga BE, sëpaku duhet të kemi binjakëzim edhe më një komunë tjetër nga BE, Kështu dy komunat nga BE dhe njëra nga shteti kandidat, do të kenë mundësi të aplikojnë te fondet evropiane. Kjo është intenca jonë që të hapim fronte të reja për aplikacione në vitet që vijojnë për ne dhe gjeneratat që vijnë. Vizituam edhe muzeun e zbarkimit të forcave aleate në Normandi dhe pamë nga afër shfrytëzimin e historisë në favor të zhvillimit të turizmit. Këtë muze e vizitonin më shumë se një million vizitorë në vit, than ë fund Argëtim Fida.

Rexhep TORTE

Pajtohuni
në gazetën
"Rruga
e Arbërit"

Tel. (04) 22 33 283.
E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.
Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

www.**dibra**.org

Oxhaqet kanë qenë një realitet i gjallë. Ata duhen parë dhe gjykuar ashtu siç kanë qënë. Pyetja është: a i kane shërbyer Oxhaqet e Dibrës çështjes kombëtare shqiptare?



Oxhaku i parë i Dibrës. Pikturë nga Sabit Bocku

OXHAQET E DIBRËS

Nga: **MOISI MURRA**

(Vijon nga numri 37, Maj 2009)

OXHAKU I HYSENAGOLLIT

Turqia Osmane njohu oxhak dhe Hysenagollin.

Hysenagolli e ka prejardhjen nga Reçi. I pari i tyre, Lek Sokoli, përmendet në dokumentet osmane që në vitin 1467 si banor i Reçit. Diku rreth viteve 1650-1680 ranë nga Reçi në Dahoshisht. Në vitin 1707 Dahoshishti ishte timar i spahiut Hysen ag Sokolit. Këtu është vendi të sqarojmë që Hysenagolli i Dahoshishtit e ka marrë këtë mbiemër nga (Hysen ag Sokoli, Hysen i ag + Sokoli). Duke pranuar rrënjen e tri gërmave të para të mbiemrit Sokoli dhe ngritje bashkëtingllores "l " d. m. th Hysen i ag + olli = Hysenagolli. Edhe Ahmeti, i biri i Hysen Sokolit, po në këtë vit, 1707 merrte zeamet, të ardhura vjetore 20.000-100. 000 akçe (monedhe e argjent turke) në vit në fshatrat Lurë, Kacni, Qidhna e Poshtme dhe e Sipërme, Mazhice dhe Gjuras. Nga prilli i vitit 1707 dhe deri në shkurt të 1714, Hyseni bashke me të birin, Ahmetin, kishin kundërshtuar vjeljen e taksave për Turqinë dhe veçanërisht taksën e xhizjes (taksë për kokë që u merrej vetëm të krishterëve). Për këtë Sulltani kishte urdhëruar për dërgimin e tyre në selinë perandorake, nëse Hyseni dhe i biri, Ahmeti, do të vazhdonin të kundërshtonin taksën e xhizjes. Gati pas një shekulli, ditët e para të shtatorit 1795, nipi i Ahmet bej Sokolit, Jusuf bej Hysenagolli, i njohur dhe si Jusuf beu i Dibrës, ngriti krye kundër Karamahmud Pashë Bushatlliut. Pasi vrau allajbeun e Dibrës, Jusuf beu dëboi përfaqësuesin e Karamahmudit, Ahmet bej Barbullushin me suitën e tij. Por më 14 shtator 1795 Jusuf bej Hysenagollin e gjejmë njërin ndër komandantët e Divizionit të III të Karamahmud Pashë Bushatlliut në luftë kundër Malit të Zi. Afrimi Jusuf bej Hysenagollit me Bushatlliun e shqetësonte vezirin e Janinës, Ali Pashë Tepelenën, i cili mori masa diplomatike e ushtarake, për ta bërë për vete Jusuf beun e Dibrës. Në fillim hapi fjalë se do ta bënte mëkëmbësin e tij në Manastir, por beu i Dibrës nuk ra në kurthin e pashajt të Janinës. Athëre Veziri i Janinës, më 7 korrik 1812, rrethoi Dibrën me pretendimin se varej nga sanxhaku i Ohrit, ku mëkëmbësi i tij Xheladin beu Ohrit e qeveriste këtë sanxhak. Pashai i Janinës që në qershor të 1812 kishte nisur të ndërtonte dy kulla në Dibër të Poshtme. Mirëpo shtrirjen e Ali Pashës në Gegëri, Jusuf bej Dibra, si shumica e feudaleve gegë, nuk e shihnin me sy të mirë. Për këtë Jusuf bej Dibra i përzuri ushtarët e Ali Pashës nga Dibra e Poshtme, që kishin nisur ndërtimin e dy kullave. Por dhe veziri i Janinës nuk ngeli me kaq. Ai i dha urdhër Meço Benos, që gjindej në Manastir me 400 ushtarë, që të marrshonte kundër Jusuf beut të Dibrës. Pashaj i Janinës kërkoi dhe ndihmën e Kapllan Pashë Toptanit, feudaleve të Matit dhe Kapidanit të Mirditës. Por dhe Jusuf beu i Dibrës i kërkoi ndihmë Mustafa Pashë Bushatlliut dhe forcave qeveritare. Kështu në korrikun e 1812 në Dibër u përqendruan forcat e koalicionit të Pashajt të Janinës nga njëra anë dhe ata të beut të Dibrës nga ana tjetër. Ali Pashë Tepelena i gjindur para presionit të Portës së Lartë dhe forcave të bashkuara të pashallarëve gegë të viseve verilindore, u detyrua të tërhiqet. Në traditën gojore thuhet se në fshatin Moravisht (sot administrohet nga Shkupi) plasën pushkët e para. Në një kullë të tipit kala qëndronte me 15 veta kapedan Kondesha (Konesha) nga Dibra e Poshtme, i cili bëri një qëndresë të fortë, por me së fundit u vra bashkë me shokët, pasi e kishte dëtmuar rëndë ushtrinë e Ali Pashës. Thuhet se kjo qëndresë e Kapidan Kondeshës e kishte trembur pashajn e Janines, i cili kishte urdhëruar tërheqjen e trupave të tij ushtarake nga Dibra me argumentin se: "kur 15 vetë me damtuan kaq shumë, po Dibra mbare sa kërdi do bënte?". Dhe me të vërtetë, sipas një kënge të vjeter, që i kushtohet qëndresës së Moravishtes, vetëm një luftetarë nga Dibra e Madhe, i quajtur Duro, kishte vënë përpara 300 luftëtarë të Ali Pashë Tepelenës. Kënga thotë:

Pushka e Duros lara, lara
Treqind toskë i vu përpara.

Po le të kthehemi tek Jusuf beu i Dibrës. Mustafa Pashë Bushatlliu e kishte vlerësuar kohë më parë Jusuf bej Hysenagollin. Ai e kishte caktuar krushkë të parë, për të marrë mbesën e Ali Pashë Tepelenës, vajzën e Veli Pashës. Më 30 prill 1812, Jusuf bej Hysenagolli, në krye të 800 krushqeve shkodran, u gjend në konakun e Ali Pashe Tepelenës dhe me 28 maj 1812, pas një muaj udhetëim, u kthye në Shkodër me nusen e Mustafa Pashë Bushatlliut. I cekëm këta detaje për të treguar autoritetin, fuqinë dhe rëndësinë që kishte Jusuf bej Hysenagolli i Dibrës. Themelimi i Oxhakut të Hysenagollit është tërësisht punë e Jusuf beut, që sipas të gjitha gjasave, Porta e Lartë e njohu oxhak, diku në mes të viteve 1790- 1795. Më vonë, në vitet '30 të shek. XIX, nga Hysenagollët do të përmendën Emin Husenagolli, në funksionet e myteselimit të Dibrës së Poshtme. Pastaj do të vinin Abdulla Pashë Dahoshishti (Hysenagolli), anëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Sali bej Hysenagolli dhe i biri Jusf beu i II . Edhe Jusuf beu i II, si Jusuf bej Hysenagolli i I, për të cilin u fol më lartë, pati një veprimtari të gjerë politike e ushtarake. Në nëntor 1912 Jusuf bej Sali Hysenagolli komandoi 2000 trupa në mbrojtjen e Shkodres kundër Malit të Zi. Nga janari deri në shtator të 1914 është prefekt i Dibrës. Në qeverinë e Turhan Pashës, iu dha posti i Ministrit të Luftës, post të cilin e mbajti nga shtatori i vitit 1914 deri në 1 janar 1916. Në 1925 është senator. Më 19 mars 1927 vritet në gjumë prej shërbëtorit të tij. Oxhaku i Hysenagollit ka qenë pak më i butë se tre oxhaqet e tjerë të Dibrës e, me gjithë atë dhe ai nuk doli nga lëkura e egërsisë. Në 1882 Hysenagolli ra në konflikt me fshatarët e Dahoshisht, për shkak se këta të fundit nuk i kishin paguar taksat. Konflikti mori përmasat e një kryengritje, që në Dibër njhet me emrin Lufta e Kërkallave. Në Luftën e Kërkallave Hysenagolli u përball, veç qendresës së fshatarëve të Dahoshishtit dhe me Malet e Dibrës (Muhurrit, Grykës Vogël, Qidhnës, Bulqizës, Reçit dhe Luznisë. Dardha, Selishta dhe Gryka e Madhe nuk arritën tu shkonin në ndihmë kryengritësve të Dahoshishtit.) Në këta luftime forcat qeveritare të komanduara nga Ibrahim Arapi, forcat e Hysenagollit e të Jusuf Karahasanit patën 120 vetë të vrarë, disa të plagosor, ku ndërmjet tyre plagoset tek Trapi i Shuplekë, në Tomin dhe Jusuf bej Karahasani. Nga fshatarët e Dahoshishtit u vranë 20 veta. Oxhaku i Hysenagollit me qendër në Dahoshisht kishte pushtet në fshatrat: Bellovë, Rabdisht Zagrad, Peshkopi, Bugjenec, Melan, Greve, Ilnicë, Trepç, Tren, Pejke, Dahoshisht, Çidhën, Cetush. Në këta fshatra kishte ndikim Teqja e Peshkopisë. Pas nëntorit të vitit 1912 influenca e Hysenagollit kishte rënë plotësisht, ashtu siç kishin rënë dhe oxhaqet në tërësi, sepse ishte fituar pavarësia dhe pushteti politik dhe administrative turk nuk ekzistonte më.

OXHAKU I XHILAGËS

Rreth viteve 1775-1710 Turqia osmane njohu oxhak dhe Xhilagën. Për Xhilagën (Xhil – aga) të dhënat jane të pakta. Thuhet se origjina e tij është turke. Në vitin 1560 përmendet një Mahmud Pashe Xhilaga, i cili duket se ishte i mëkëmbur, për deri sa kërkonte të ndërtonte një kala në Deshat. Kënga thotë:

Mahmud Pasha n'at Deshat
Na ka çitun nji bidat…
Grejti duart e bani dua,
Për me grefun nji kala…

Mahmud Pasha Xhilaga, sipas traditës gojore, nuk arriti ta ngrejë kalanë në Deshat. Banorët e fshatrave përreth e kundërshtuan fortë. Pas Mahmud Pashë Xhilagës përmendet Mustafa bej Xhilaga, i cili duket se mori pjesë dhe u dallua në luftën ruso – turke, 1770-1774, ku dhe u shpërblye nga Porta e Lartë, duke e njohur oxhak. Pastaj përmendet Sulejman bej Xhilaga, që shërbeu si një nënpunës i dorës së dytë në Peqin e Kavajë. Hoxholli, siç u fol me lartë, çoi njerëz dhe e vrau atje. Edhe Xhilaga më se një herë ka pas konflikte me fshatarët e semtit të tij. Rasti më i tonditës ka qenë ai i konfrontimit me armë me dy fiset e Sahodollit, Tafën e Zunën, ku nga të dyja palët u vranë më shumë se 30 veta. Më vonë pleqtë e urtë të këtyre dy fiseve dhe Oxhaku i Xhilagës bënë që të kapërcehej kjo gjakderdhje primitive dhe jo vetem kaq, por bënë dhe krushqi. Oxhaku i Xhilages me qendër në Deshat, e shtrinte pushtetin në fshatrat: Borovjan, Deshat, Staravec, Zimur, Bahute, Shimçan, Limjan, Sohodoll, Vrejt, Venisht, Dipjak, Sllovë, Shumbat, Palaman, Lugje, gjithë fshatrat e Dardhës, të Reçit dhe lagjia Kabe të fshatit Pilafe. Në fshatra e semtit të Xhilagës, nga ana fetare vepronin tri teqet e Dibrës së Poshtme: Teqja e Limjanit, e Borovjanit dhe e Vleshës. Thuhet se Xhilaga ka pas një top të cilin e përdorte për të çelë iftarin në kohë ramazani. Xhilaga këtë e shpjegonte sikur këtë punë e bënte për tu treguar oxhaqeve të tjere se mund të hahej buke (të çilnje iftar) vetem kur të urdheronte ai. Per t'ia prishur këtë gjest, Karahasani dhe Hysenagolli, nxiten lodraxhinjtë t'iu binin lodrave para se të shtinte topi i Xhilagës. Njerëzit nisen të flasin: "A, hë, Xhilagës iu lag baruti."

Kjo e detyroi Xhilagën të hiqte dorë nga e shtimja e topit në kohë ramazani. Në mënyrën e jetesës Xhilaga qëndronte një shkallë më larte se Oxhaku i Hysenagollit dhe i Karahasanit. Zonjat e Xhilagës visheshin si në Sheher (qytet të Dibrës së Madhe), gatuanin si në shehër, përshendesnin si në Shehër, duke vënë pas emërit titullin bej p. sh: "Si shkove Ali bej?"'. Me fjalë të tjera në të gjithë qenjen e tyre dominonte kultura e orjentit, e denjët për familjet aristokrate.

* * *

Oxhaqet kanë qenë një realitet i gjallë. Ata duhen parë dhe gjykuar ashtu siç kanë qënë. Pyetja më e lehtë që shtrohet është: a i kane shërbyer Oxhaqet e Dibrës çështjes kombëtare shqiptare? Po dhe përgjigjja është e lehtë: Oxhaqet e Dibrës, jo vetem nuk i kanë shërbyer çështjes kombëtare shqiptare, por përkundrazi e kanë dëmtuar rëndë. Faik Konica, duke bërë fjalë për oxhaqet, shkruan se kjo klasë, në Shqipëri njihej dhe si "Dyerte e vjetra" e "Dyerte e mëdha", e nga te huajt dhe si "Fisnikëria shqiptare", dhe "borgjezia e lartë latifondiste". "Të trija këta përcaktime, - vazhdon F. Konica, - kanë diçka të vërtetë, por secila prej tyre mund t'i nënshtrohet kritikës. Nuk ishin fisnik në kuptimin e vërtetë të fjalës, sepse asnjë dekret nuk u kishte dhënë të drejtë të quheshin të tille; nuk ishin as kastë, sepse nuk mbeshteteshin në organizimin fetar. Nuk ishin as latifondistë, sepse ligji islamik e ndante pasurinë në mënyrë të barabartë, pa i dhënë mundësi asnjërit nga fëmijët të trashëgonte gjithë pasurinë. Në etapen e fundit të rënjes, oxhaqet, afruan pranë vetes njerëz të fortë, familje me emër, me qëllim, që jo vetem të mos shuheshin, por dhe të ruanin pozitat e tyre feudale në sistemin centralizues osman. Në këtë mënyrë, oxhaqet pa e kuptuar dhe vetë krijuan një shtresë të re, që parapelqyen të vetquhen, apo i quajtën "Paria e Dibrës", e "Krerët e Dibres", por për këta do të bëjmë fjalë një herë tjetër.

Oxhaqet e Dibrës, jo vetem nuk i kanë shërbyer çështjes kombëtare shqiptare, por përkundrazi e kanë dëmtuar rëndë.
Në etapen e fundit të rënjes, oxhaqet, afruan pranë vetes njerëz të fortë, familje me emër, me qëllim, që jo vetem të mos shuheshin, por dhe të ruanin pozitat e tyre feudale në sistemin centralizues osman.

intervistë

Bisedë në Athinë me z. Esat Ruka,
Drejtor i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike.



UNË ERDHA SHQIP DHE PO SHKOJ SHQIP

Esat Ruka është nga fshati Rremull i Matit. Është i diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve në vitin 1975. Ka punuar gjithë jetën në institucionet kulturore që nga fshati e deri në pozicionin e sotëm të drejtorit të Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Është marrë me drejtimin e grupeve folklorike, me krijimtari, me interpretimin e këngës popullore, me gjithçka që lidhet me lëvizjen artistike...

Esati ishte të dielën më 7 qershor mysafir midis grupit folklorik lab "Vëllazërimi" në pesë vjetorin e tij.

Foli duke vlerësuar lart grupin e në veçanti drejtuesin e tij, rapsodin e këngës labe në mërgim Kastriot Lekdushin, dorëzoi një kupë dhe, mes duartrokitjesh të zjarrta këndoi me shpirt një këngë të njohur arbëreshe, këngë himn për mërgatën shqiptare të të gjitha kohërave.

Mbrëmjen e së hënës, pas një kafeje dhe një bisede shumë të ngrohtë me grupin "Vëllazërimi" gjeta rastin për të zhvilluar me të një bisedë, bisedë e cila nuk kishte se si të mos udhëtonte maleve të Matit dhe të Dibrës për tu ndalur në Zall – Dardhë, në 60 vjetorin e Ansamblit të njohur "Kuvendi" të këtij "Mali të Dibrës", gurrë e madhe e folklorit të Dibrës.

* * *

Të nisemi nga Mati, nga ajo luginë e bukur dhe nga ato male madhështorë që mbajnë në gji këngë e melodi që kanë përkundur djepin e krijimtarisë suaj...

Unë jam bartës i vlerave të folkut të Matit. Duke qenë i tillë e kam filluar me rapsodi, njoh instrumentin e çiftelisë, kam punuar me sharki, shkolla më mundësoi të njoh mandolinën, kitarën. Mati është pika ime e referencës në tematikë, përveç melosit, sigurisht të mbështetur tradicionalisht në muzikën e trevës sime.

Jeta e gjallë artistike më ka zgjeruar tematikën, bashkëpunimet. Kam shkruar vetë muzikalisht shumë, këngë dhe rapsodi, edhe muzikë të kultivuar. Rapsoditë nuk janë të stilit origjinal të këngës malësore porse janë tërësisht të mbështetura. Janë rapsodi që ndërrojnë njëra nga tjetra, nuk janë njëlloj në melodi. Mund të përmend këngën për Isa Buletinin, një këngë që diaspora shqiptare në veçanti, e njeh masivisht prej më se njëzet e pesë vjetësh.

Kam kënduar mjaft këngë që lidhen me emra personalitetesh të hapësirës historike shqiptare, të ngjarjeve kombëtare. Nuk kam kënduar në një terren bosh. Kam gjetur një traditë kulturore dhe rapsodie. Kemi pasur Qamil Xhikën, kemi pasur Nezir Nelin në Mat. Sigurisht Hazis Ndreu ka qenë një pikë shumë e rëndësishme në tibrikën, në tematikën, në karakterin dhe të tjerë e të tjerë. Jeta artistike, vazhdimisht në veprimtari kombëtare, më ka përballë me shumë personalitete të këngës shqiptare të të gjitha zhanreve. Angazhimi qytetar në folklor, të cilin unë mendoj se ka vend në aspektin e informativit të një vlere gjithëpërfshirëse, të një vlere konstrukti fjale shqipe të menduar, të punuar bukur, në tingëllimin e një melosi shumë të saktë, të një fraze melodie krejt të kapshme, krejt të dashur për njerëzit. Kjo ka bërë që të provoj duartrokitjen masive, stimulimin por edhe ndonjë fshikullim, sepse artisti nuk i shpëton dot atij. Jam krenar, sepse me të vërtetë kam pas në krah personalitete artistësh shumë të mirë. Në Mat Feride Kurtin, në Dibër Hazis Ndreun, në Mirditë...

Jemi tek folklori. Në jetën time si gazetar më është fiksuar shprehja se folklorit në këto treva, e kam fjalën për Dibrën dhe për Matin, sapo i është hapur thesi prej të cilit kanë dalë perlat e para.

Është e vërtetë.

Si do ta përshkruanit këtë vlerë për këtë trevë të madhe ku vonë ka filluar të shkruhet arti dhe kultura popullore?

Ju e keni fjalën vetëm për Dibrën dhe Matin apo...?

Për Dibrën e Matin me që jemi unë dibran e ju matjan.

Dibra dhe Mati janë dy treva me një begati shumë të madhe vlerash në gjerësinë e vet të folklorit. Folklori nuk presupozon vetëm pjesën e skenës, këngën dhe vallen. Folklori është edhe kostumi, edhe ritet pagane. Ju jeni dëshmitar vetë që në një periudhë goxha të gjatë nuk ishin në plan të parë ritet e Shëngjergjit, Ditës së Verës, Nevruzit, Shën Kollit, Shën Mitrit, festat fetare etj. Ishte pjesë e një politike tjetër. Rikthimi në këtë korsi është shumë i nevojshëm, sepse në fund të fundit këta përbëjnë edhe rrënjët e traditës së hershme.

Sigurisht pastaj janë këngët e kurbetit në gjirin e këngës, këngë nizamësh, këngë trimash...

Me që jemi në kurbet. Me që mbrëmë ndjeva një kënaqësi të veçantë kur ju dëgjova të këndoni një këngë kurbeti...

Është një këngë arbëreshe e cila ka edhe krenarinë, edhe krahasimin...

A mendoni, duke pas parasysh edhe veprimtarinë e mbrëmshme, se duhen studiuar edhe risitë e reja të krijimtarisë në kurbetin shqiptar në Greqi dhe në vendet e tjera? Mua më duket se është hedhur një farë e cila ka nxjerrë rrënjë, ka nxjerr filiza, po gjelbëron për të shkuar drejt lulëzimit. Cili është mendimi juaj?

Unë mendoj se së pari duhet ta njohim dhe ta stimulojmë si një vazhdimësi në aspektin e kësaj teme në folklorin tonë. Këngët e kurbetit kanë përbërë një pjesë shumë të rëndësishme të repertorit të këngëve tona tradicionalisht..

Oj fusha e Korabit, o e mjera unë,
Ti më erdhe hakut, o e mjera unë...

Lirie Rasha. Këta kanë qenë këngë që i ka kënduar jo vetëm gratë por edhe burrat. Të përbashkët kanë dhimbjen ashtu si edhe qëndresën, por në pikëpamjen e melosit ndryshojnë, kanë specifikat e veta që lidhen me gjininë por edhe me aspektin historik. Referimi i kësaj teme në një krijimtari të re, sigurisht pak më i evoluar sepse bëjnë efektin e vet mjetet e propagandës, radioja, televizioni, ballafaqimet artistike, komunikimi, kanë krijuar tjetër shtrirje në lidhje me formatin muzikor.

Unë vë re se kjo veprimtari që u zhvillua dje ishte kurorëzimi i një kontributi pesëvjeçar të një grupi të spikatur lab "Vëllazërimi" me të cilin unë kam pas fatin të njihem në skenë me ta. Me të vërtetë meritojnë stimulim, meritojnë vlerësim. Nuk ka dyshim se ata e duan shpirtërisht këtë.

Ata mblidhen në një podrum, në një izbë, për ta kënduar këngën...

Edhe ky është një tregues që tregon dashurinë dhe respektin që kanë për këngën. Unë jo vetëm i uroj dhe i përgëzoj ata por në një far mënyre i kam edhe pikë referimi duke qenë edhe vetë artist, i çmoj dyfish.

A morët ndonjë mesazh prej tyre?

Unë mora një mesazh të madh. Unë, ndonëse për herë të parë në pozicionin shtetëror vij në Greqi, mendoj se:

Së pari kontaktet shtetrisht duhet të jenë shumë më të shpeshta,

Së dyti, njohja duhet të jetë shumë më racionale,

Së treti stimulimi duhet të jetë shumë më serioz.

Unë mendoj që shteti, jo ka vend për ta vlerësuar, por shteti ka detyrim për t'i vlerësuar, për t'i respektuar, për t'i stimuluar dhe pse jo, për t'i mbështetur.

Sigurisht, në kushtet konkrete që jemi shteti ynë nuk ka prioritete shumë serioze në aspektin kulturor në rastin e folklorit sepse ka probleme madhore shumë serioze. Por unë mendoj se vrapi për plotësimin e disa treguesve të tjerë ekonomikë do të çojë shumë shpejt në një përkujdesje konkrete edhe në këtë lëmë.

Ndoshta, do të thosha figurativisht që "dasma kombëtare" që përmbledh të gjithë këto halle, se dasma do edhe lodrën, edhe culën, edhe klarinetën, edhe çiftelinë, edhe dajren...A mos ndoshta shteti duhet të mendojë pak më shumë për këtë anë të "dasmës" së vet?.

Kjo është pjesa vezulluese e dasmës. Atje ku ka rreze njerëzit kthejnë sytë. Por ndodh që rrezet rrezatojnë shumë shpejt por edhe shuhen shumë shpejt. Gjithsesi ardhja ime tregon një përkujdesje shtetërore. Unë personalisht kam afeksion për artistët amatorë, jam i pashmangshëm në angazhimet e mia. Shpresoj të vazhdoj në këtë pozicion që kam. Do të jem më afër, jo se afrimi im ka një zgjidhje përfundimtare, por që për artistin edhe një fjalë e mirë, një fjalë e ëmbël, një fjalë shqip, e drejtë, e ndershme, e pastër, bën efektin e vet.

Unë kam bërë shumë intervista me arvanitas. Më ka befasuar gjuha e tyre, gjuhë e cila nuk ndryshon shumë me gjuhën shqipe. Kam dëgjuar edhe një grup arvatitësh, grupin e Thanas Moraitit, kam edhe dy kaseta me një lumë të tërë këngësh arvanite, shqip. A mos ndoshta në festivalet tona folklorike, siç vijnë arbëreshët e Italisë, duhet të vijnë edhe arvanitët e Greqisë?

Unë ta kam zili këtë arkiv që ke siguruar dhe do të kisha thënë: Mos pusho së siguruari vlera të tilla të cilat janë vërtet rrënjët e origjinës, rrënjët e kontributit tonë kulturor. Mund të them që arvanitasit kanë qenë në festivalet kombëtare, nuk është se nuk kanë qenë. Ndoshta nuk kanë marrë pjesë me të gjitha dimensionet që meritojnë dhe që duhet, por kanë qenë.

Në shtator të këtij viti, nga 24 – 29 shtator, jemi në Gjirokastër. 29 Shtatori është Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore, ditë që përkon me mbylljen e festivalit. Kështu është menduar. Unë do të insistoj, madje do të ishte mirë që ju të ishit "krushku i parë" i kësaj sipërmarrjeje.

Do të jetë një kontribut shumë i mirë që një grup arvanitësh të këndojë në Gjirokastër, të përshëndesë në Gjirokastër ashtu sikundër ne, komiteti organizator, ose më mirë politika jonë shtetërore në këtë drejtim, duhet t'i përshëndesë ata dhe t'i përgëzojë për gjithçka ata ruajnë në shqip, që transmetojnë në shqip, sepse në fund të fundit qëllimi ynë ky është: të njohim rrënjët tona, t'i vlerësojmë ata, t'i transmetojmë ata në gjeneratat e reja në mënyrë që kjo shqipe, tashmë me përmasa të tjera, e shkruar bukur, e futur në anale moderne të marrë përmasat që meriton.

Unë pashë dje në veprimtarinë e grupit "Vëllazërimi" një mobilizim kolektiv, total, jo vetëm të grupit por edhe të shumë shoqatave të cilat kanë sensibilitet për këtë dhe kjo më gëzon shumë. Mu duk se ishte një gërshetim shumë i mirë intelektual edhe i traditës. Shumë botues kishte, shumë krijues, drejtues shoqatash edhe biznesesh. Edhe prania e ambasadorit për mua ishte shumë domethënëse. Këta janë faktorë të cilët edhe pse ngandonjëherë ne evidentojmë vetëm atë që na mungon, sepse kjo na shqetëson, por gjithsesi një tjetër i tretë që vë re tregues të tillë xhelozohet dhe mendon se e nesërmja do të jetë sigurisht më kompakte, në nivele shumë më të larta. Edhe unë për këtë, edhe ju zoti Ashiku ju falënderoj me gjithë kontributin që jepni, me gjithë mbështetjen. Me tendencën e një gazetari që përpiqet të lerë gjurmë në këto ndryshime, në këto pjesë të reja që ndoshta ne, vërtet me vështirësi por nuk duhet të harrojmë asnjëherë se të tjerët po na shohin si vitalë, nuk na shohin si të squllët. Kjo nuk është pak për ne.

Nesër kthehesh në Shqipëri. Me çfarë barre përshtypjesh do të udhëtoni?

Unë erdha shqip dhe po shkoj shqip. Kjo është e rëndësishme në udhëtimin tim në Greqi. Më vjen mirë që kjo shqipe, një shqipe e profilit artistik, kulturor, trashëgimie vjen e përcjellë nga shumë treva shqiptare. Jam shumë i nderuar për këtë.

Pa marrë frymë, nga Athina do të shkoj në Zall-Dardhë të Dibrës...

Nuk do ta gjesh shtëpinë e kulturës të Xhelal Çerpes...

E di.

Ajo ka qenë shtëpia e fundit e kulturës në Dibër që është shembur.

Ne njerëzve të artit, të kulturës dhe të trashëgimisë mund të na shemben kullat por nuk na shembet krijimtaria.

Do të ngjiteni në Lashkizë ?

Nuk e di, besoj se po.

Po u ngjitët në Lashkizë shko e mbushi grushtet me ujin e Gurrës së Rashe. Mos harro të ngjitesh edhe në Kodrën e Rashe prej së cilës shihet jo vetëm panorama e mrekullueshme e Luginës së Drinit dhe malet me Korabin në ballë por edhe burimi e legjendave dhe këngëve epike të Malit të Dardhës. Prej atje është afër Sorica e Hazis Ndreut të madh të këngës, valles e të folklorit dibran...

Do të festojmë, më 12 qershor 60 vjetorin e Ansamblit "Kuvendi" të Dardhës.

Ta kam zili.

Do të jenë të gjithë këngëtarët me emër përveç të ndjerit Hazis Ndreu. Do të vijnë nga e gjithë zona. Kemi marrë masa organizative dhe mendoj se do të jetojmë çaste shumë të bukura, atje ku breza të tërë kanë krijuar një mal me krijimtari, një mrekulli.

Të kam zili.

Të ftoj të vish.

E kam të pamundur.

Atëherë do të të kujtoj.

Kë të takosh t'i përcjellësh të falat e mia, veçanërisht Xhelal Çerpes, një njeri që e dua dhe e respektoj shumë.

Xhelalin e ftova vjet në Burrel, në një mini festival dhe i dhashë një mirënjohje në emër të institucionit për kontributin që ka dhënë si njeri i kulturës.

Faleminderit i dashur Esat! Më emocionuat, më morët e më çuat maleve të Dibrës dhe të Matit, pika e dobët në shpirtin tim.

Janë male që, më vjen keq, por që nuk e mbulojmë dot lavdinë e tyre me krijimtari. Përpjekje po bëjmë në mënyrë maksimale.

Bisedoi: Abdurahim Ashiku

Athinë, 8 qershor 2009

Respekt për brezat e arsimit në Bulqizë

Bulqiza ka pjesën e saj të historisë kombëtare edhe në fushën e arsimit. Jo në kuptimin e thjeshtë se kjo krahinë ka qenë tre herë qytet përgjatë historisë, por dhe në atë të vlerave kulturore e arsimore që ajo mbart e përcjell nga njëra periudhë në tjetrën, ku fillimet e arsimit në këtë krahinë janë të hershme, e roli i mësuesit është i domosdoshëm dhe parësor në përçmimin e dijes dhe të profesionit në breza. Këtë fakt na e sjell të freskët autori i librit "Bulqiza dhe bulqizakët", ku e përshkruan hollësisht fillimet e dijes fillimisht në shkrim dhe këndim arab-latin e më pastaj në shqip. Puna në shkollë ka ardhur në rritje, fillimisht disi e veçantë me grupe të vogla, pastaj në formë shtëpie dhe me çlirimin e vendit pas viteve 1944, me kurse të veçanta në zhdukjen e analfabetizmit, pastaj në shkolla të grupuara.

Ku u hap shkolla e parë shqipe në Korçë më 1887, Naimi vjershëroi:

"... Sot vunë gurin e parë,
E bukur është kjo ditë
Lumja ti, moj, Korçë lule
Që le pas shoqet e tua..."

Kështu që mbas një pune të gjatë e të madhe të komisioneve, më 13 gusht të vitit 1946, Kuvendi Popullor i asaj kohe, aprovoi ligjin për reformën arsimore. Arsimi e kultura e re do të ngrihej mbi bazën e urdhrave e dispozitave ligjore të shtetit të ri shqiptar, të cilat kishin dalë para dhe pas reformës.

Menjëherë del një "Qarkore e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar mbi çeljen e shkollave e kurseve kundër analfabetizmit për të rritur nivelin e arsimit, më 13 gusht 1944, Dekreti nr. 4, ku u drejtohej të gjithë këshillave nacionalçlirimtare të qarqeve me objekt: Mbi çeljen e shkollave fillore e të kurseve për të rritur pjesëmarrjen në to, të atyre që s'dinin të shkruanin e të lexonin. Këshut që në krahinën e Bulqizës u ndërtuan katër shkolla fillore këto në vitin 1946, ku deri në këtë kohë ishin grumbulluar e dhënë mësim në shtëpitë e fshatarëve.

Në bazë të këtyre dispozitave shkolla fillore do të ndiqej me detyrim prej të gjithë fëmijëve që kishin mbushur moshën shtatë vjeç e lartë. Masivizimi i arsimit ishte detyra parësore ndaj ajo ishte mishëruar si në ligjet dhe dispozitat, ashtu edhe në Reformën Arsimore të sapomiratuar. Reforma u bë një mjet i fuqishëm për të çuar përpara zbatimin e ligjit, për të përhapur arsimin e kulturën në të gjithë vendin. Për dhjetë vjet pothuajse u zhduk analfabetizmi për moshat dyzet vjeç e poshtë, si për burra dhe për gra. Viti 1954 shënoi fundin e kësaj plage disa shekullore, veçanërisht në zonat e thella malore. Në këtë aksion të rëndësishëm u përfshinë edhe ata që kishin mbaruar shkollën fillore në Zhirane apo në Dushaj e në Vajkal, nga vitet 1902-1928-1933. Në vitin



> Ishin vite të vështira. Motrat Peme e Lima Duva, kishin mbaruar shkollën fillore në atë fshat të thellë malor, Dushaj. Edhe në vështirësi, babai i tyre Saliu, mori përsipër t'iu plotësojë dëshirën vajzave që të shkolloheshin dhe të bëheshin të afta për t'i shërbyer vetes e shoqërisë.

1946 e gjetën veten të mbushur me nxënës shkolla fillore në Dushaj, në Fushë, në Qafë të Dragunit, ku mësonin fëmijët e fshatit Koçaj e Dragu dhe ajo e Vajkalit, ku mësim jepnin mësues nga krahina të tjera dhe ata vendas që kishin mbaruar më parë. Është për t'u theksuar se disa nga këto që mbaronin shkollën fillore, i drejtoheshin Zerqanit për të vazhduar shkollën Unike, disa shkonin me bursë në qytetet e Peshkopisë, Tiranës, Shkodrës apo të Elbasanit që më vonë u bënë kuadrot e ardhshëm.

Theksojmë se fitorja më e madhe arsimore ishte hapja e Universitetit Shtetëror të Tiranës 1957. Ngritja e institucionit më të lartë arsimor e kulturor ishte vazhdim i ëndrrave largpamëse të rilindësve tanë. Kështu që ky sihariq në këtë vit erdhi dhe për bulqizakët që në Fushë-Bulqizë u hap shkolla Unike (shtatëvjeçare) ku shumë djem e vajza e vazhdonin në vendin e tyre të lindjes. E tillë u hap dhe në qytezën e Minatorëve, ku përveç nxënësve, studionin dhe minatorët e gjeologët, ku një pjesë e madhe e tyre ju drejtuan faltoreve të Univesitetit në specialitete të ndryshme.

Krahas atyre që kishin mbaruar në Zhiranë, u aktivizuan dhe shkuan me







bursë jashtë rrethit dhe Shefqet Tançi, Hasan Duriçi, Hysen Balla, Rakip Alliu, Xhemal Karaj dhe më pas motrat Peme e Lime Duva ku të gjithë këto punuan për dekada në arsim, e sot një pjesë janë në pension pleqërie, ndonjë prej tyre ka ndërruar jetë.

Ishin vite të vështira. Motrat Peme e Lima Duva, kishin mbaruar shkollën fillore në atë fshat të thellë malor, Dushaj. Edhe në vështirësi, babai i tyre Saliu, mori përsipër t'iu plotësojë dëshirën vajzave që të shkolloheshin dhe të bëheshin të afta për t'i shërbyer vetes e shoqërisë. Ata ishin vajza shembullore si në mësime, disiplinë apo paraqitje të cilat kërkonin t'i shtonin dijet e tyre, pra bursën ta siguronin vetë si nxënëse të dalluara në të gjithë treguesit. Pemja, pasi mbaroi shkollën fillore, uniken e mbaroi me bursë në qytetin e Shkodrës, ku në këtë qytet mbaroi dhe dy-vjeçaren për mësuese e ciklit të ulët, e më pas u kthye dhe mësoi nxënësit e asaj shkolle ku kishte mësuar vetë të shkruajë e të lexojë. Ndryshe ndodhi me motrën e vogël të Pemës, Limen. Kjo Uniken e bëri në Fushë-Bulqizë, ku dhe kjo ishte mjaft mirë me mësime. Këshut që Limja në vitin 1962, bëri kërkesë për në Pedagogjiken e "8 Nëntori" në Peshkopi. Pra të njëjtën rrugë dhe profesion zgjodhën të dyja motrat vetëm e vetëm t'i shërbenin vendlindjes që për atë kohë s'qe e kollajtë pasi mentaliteti për femrat ishte disi ndryshe.

Ashtu një vjazë e vogël e simpatike, u ul në bankat e shkollës Pedagogjike duke treguar një kujdes të veçantë, ku shumë shpejt fitoi respektin e nxënësve dhe të Profesorëve të talentuar të kësaj faltoreje që pothuajse luante rolin e një Universiteti, ku mësuesit Zenel Sula, Shemsi Manjani, Islam Kosova, veçanërisht mësuesi kujdestar Kadri Zhulali u kujdesën kaq fort për këtë vajzë, ashtu si për fëmijën e tyre, që Limja e mbaroi këtë shkollë dhe përfitoi profesionin e nderuar të mësuesit. Pra në këtë krahinë këto qenë dy mësueset e para që thyen konceptin e arsimit.

Limja filloi punë si mësuese në vitin 1967, në atë shkollë ku kishte qenë vetë nxënëse për 4 vjet. Mësimin e filloi me klasë kolektive, më vonë me klasa të veçanta. Si Pemja dhe Limja kishin ëndërr për të vazhduar studimet e larta. Por Pemja u martua e krijoi familje në qytetin e Bulqizës, dhe ëndrrën e saj e realizoi i biri Vladimiri, ku mbaroi universitetin dhe u titullua inxhinier. Kështu që Limes i ngeli shtëpia me dy të moshuar dhe s'arriti të vazhdojë më tej.

Si Pemja dhe Limja, kaluan ndër duart e tyre me qindra e qindra nxënës që u shkolluan në të gjitha specialitetet. Nxënësit që iu ka dhënë mësim Limja. Nga fshati Dushaj, janë bërë juristë, oficerë, inxhinierë, mësues, të cilët asnjëherë s'e heqin nga goja mësuesen e tyre gojëmbël z. Lime, në mes tyre dhe djali i saj Klodiani, ju drejtua universitetit dhe u titullua inxhinier, ku sot punon në emigracion.

Sa e sa janë të tjerë mësues si këta, që kanë dhënë kontributin e tyre për dekada, që kanë marrë tituj e dekorata për punën e tyre të nderuar, që s'arrijmë t'i përmendim në këtë shkrim, të cilëve ju urojmë jetë të gjatë e shëndet të plotë e kënaqësi familjare. Ngelën të respektuar sa të jenë gjallë e do të kujtohen nga brezat e ardhshëm.

YMER KETA

kujtesë

Rekuiem për një shembëlltyrë
njeriu dhe sportisti, njëzet vite pas vdekjes

TUFI, 'YLLI' QË ENDE JETON NË SHPIRTËRAT E DIBRANËVE



Nga: **Nefail SPAHIU**

Në jetë ka plot rendje dhe këto rendje vësh tirë t'i kapësh, herë vrapojnë raivigineve nostalgjike, herë mbeten në rendje për t'iu larguar vetmisë, për të gjetur fuqishëm domethënien e jetës gjithnjë midis heshtjeve të këputura. Në këto rendje, njeriu si krijesë e hyjnisë gjurmon fshehtësitë dhe beftas e vëren veten në enigmatikun e këtyre mistereve dhe atëhere kujtohet pse jeta e njeriut është fshehur në Zotin dhe në këte Zot vëren vetveten, kërkon hyjet, kërkon hyjet, ngjyrat, sharmin e jetës dhe në këto çaste të vërshimit të shpirtit na kujtohen vlerat e dikujt, bizhdësia, vlera këto që janë simbol i miqësisë dhe sinonimet të mallëngjimit për dashuri midis njerëzve… Mjafton ta mbani ndezur dritën e do të shihni sferat e dashurisë mbarënjerëzore, e kjo dritë ka hije, por në të ka diç të pa zbuluar. Një fytyrë që është epiteti i sportistit të talentuar, njëriut me vlera shumë dimensionale - Triumf Turkeshi, cili edhe pas dy dekadave të ndarrjes nga kjo botë (më l6 qershor) ndriçon amshueshën në botën e territ…

Dibranët gjithnjë e kanë dashur arësimin. Ata si njalat kanë udhëtuar larg. Kanë kaluar kufinj, shtetëror e administrativë dhe kanë arritur deri tek shkolla. E si për çudi nëse do të kujtosh vitlindjen e dikujt, kujto gjeneratën e shkollimit. Kështu mes dibranëve ke ata të shkollës së Kastriotit, Normales së Elbasanit, ke gjeneratat e Normales së Shkupit, Studentët e Beogradit, zagrebasit, për të ardhur deri te Shkupi e për tu ndalur në Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë e deri tek Universiteti i Tetovës...

Është e madhe lista e qendrave dhe emrave të qyteteve ku dibranët kanë shkuar për shkollim. Bile dibranë në shkollim ka pas edhe në Stamboll, Selanik, Kairo, në universtet e Italisë dhe në mbarë Europën, ku dibranët mësuan shkrimin dhe kulturën e vet dhe të popujve të tjerë.

> Triumf Turkeshi, me aktivitetin e tij shumëdimesional, veçmas në lëmin e sportit, që e përjetësoi sot emrin e tij, për Dibrën nuk ka vdekur, i tillë do të mbetetn në jetë të jetëve, meriton që të paktën ndonjeri prej klubeve, turëneve apo institucioneve sportivë ta mbajë emrin e tij
>
> *Dibër, 14 qershor 2009*

Në vitet e para pas çlirimit të vendit, nga viti 1947 e deri vonë, në Shkup nisi punën Normalja e Shkupit. U hap një vatër për arsim dhe kulturë për shqiptarët nga Maqedonia e rajoni. Dhe në mesin e këtyre shkollarëve shqiptarë, jetuan dhe vepruan edhe gjenerata dibranësh. Edhe sot dibranët e njohin gjeneratën e Nehat Bellcishtës, Avni Zllatkut, Besim Rusit, Mojsi Lutfiut, Shaban Shemsiu, Mahmud Hysës, Lutfi Markut, Bardhyl Camit, etj… Gjeneratën e Triumf Turkeshit, Ferit Vojnikës, Qenan Mejzinit, Bardhyl Pustinës, Petrit Dibrës, Skender Rekës, Rexhep Erbelit, Gafur Bollicit, Rizvan Kolecit, gjeneratën e Zuhdi Dacit, Skender Selës, Ibrahim Egriut, Lutfi Cukës, Xheladin Pjecës, Azis Kërlukut, Medat Vojnikës Mediha Kërliut-Camit, Mirushe Muça-Qormehmeti, Engjellushe Daci-Pasholli, Flora Shehu…

Edhe shumë gjenerata dhe emra tjerë, të cilëve ju kërkojmë falje që nuk i rradhitëm në këtë shkrim.

Për shumëçka këto gjenerata të normales të Shkupit edhe sot e kësaj dite mbahen mend. Mbahen mend për aatë numër të madh arsimtarësh, që sot mbajnë arsimin në shkollat fillore dhe gjimnazin e dibrës e gjetkë. Mbahen në mend si aktivist veprimtarë e sidomos për një gjeneratë teje të talentuar, atë të sportistëve, si të ndjerit Triumf Turkeshi, Qenan Mejzini dhe bashkë lojtarët e tyre Bardhyl Pustina, Qenan Kaba, Abdul Ramku, Gëzim Ostreni, Veap Popinara etj.

Por, si sportist më i dalluar ishte Triumfi.

I gjithëanshëm ishte Triumfi, pinjol i një familje atdhetare që shquhej me aktivitete të gjthanshme kulturo-shoqërore e veçmas sportive. Që si nxënës ai dallohej për aktivitete sportive. Normalja, si vatër e edukimit të gjithanshëm kultivonte edhe degët e sportit. Në të gjitha Triumfi, ose siç e quanin shokët Tufi angazhohej dhe ishte i dalluar. Luante me sukses të madh në ekipin e "Jugomontazha"më vonë KH JUG si dhe lojën e futbollit njëherit me sukses luante edhe ping-pong, volejboll etj. Tash pas sa vitesh, tash 20 vite nga vdekja e hershme e tij, dibranët, por jo vetëm ata po edhe shkupjanët, tetovarët, struganët. . . e kujtojnë ndoshta në biseda kujtimi, edhe shumë tash në moshën e tij, në Kosovë dhe gjetkë në Ish-Jugosllavi me të cilët triumfi ka luajtur henbollin e tij që mbahet në mend se kishte karakteristikat e tij të lojës. Ai i njihte fshehtësitë të lojës kishte mënyrën e vet të gjuajtjes të penalltive cilësi këto që e çuan deri në dyert e reputacionit shtetëror. Triumfi luajti në një kohë e cila ndoshta për sportin tonë ishte e hershme. Ai me sukses luajti edhe futboll për disa vite për skuadrën futbollistike të Korabit. Por ai u gjind në sport ngase kishte talent dhe shpirt sportisti. Atë e tregoi edhe pas sa vitesh, ku në Diber u bën përpjekjet për ringjalljen e henbollit. U angazhua, vrapoi pas talentëve të ri. Vrapoi për sigurimin e kushteve. Por nga rrethana dhe motive, ndoshta edhe të njohura pa i përmend vrapoi dhe entuziazmi i tij u ndal. Ndoshta u ndal edhe për atë pse pikërisht vraponte dhe ishte vullneti i Triumfit veprimtaria dhe aktivitetet e tij në lëmin e sportit dhe në SH. K. A. "Liman Kaba" dhe aktivitetet e tjera atdhetare ishin halë në sytë e pushtetarëve të atëhershëm. Shoqëria e tij si Ferit Vojnika, Naxhi Osmani, Sami Ibraimi sidomos familjarët bashkëshortjaa Nazifja, djali Arbeni, vajza Arbëresha, vëllezërit Pertefi dhe Bujari, motrat Bejtulja dhe Flora dhe mbarë bashkëqytetarët kanë shumëçka për të kujtuar në këtë përvjetor për Tufin, emri i të cilit do të bëhet dritë vizionare për sportin dibran ndaj, është koha që ndonjë klubi sportiv, institucioni sportiv të mbajë emrin e tij.

Me aktivitetet, veprën dhe vyrtytet ai e përjetësoi emrin e tij. Për dibrën Tufi nuk ka vdekur, është i gjallë për jetë të jetëve.

Shpallen fituesit e edicionit të tretë të Çmimit AIITC

Ethet e konkurrentëve në "Çmimin AIITC" u kurorëzuan të hënën, më 22 qershor, në një ceremoni festive, ku u shpallën emrat e fituesve për krijimtarinë e vitit 2008.

Studiues, artistë dhe personalitete të ndryshme konkurruan midis tyre për të fituar çmimin e madh për tre kategoritë, pikërisht për librin më të mirë në fushën e shkencës dhe të kulturës islame, për pikturën më të mirë dhe për krijimtarinë më të mirë për moshat e reja.

Mision qendror i çmimeve AIITC është stimulimi dhe motivimi i krijuesve shqiptarë për prurjet e tyre artistike e shkencore, të cilat gjykohen me objektivitet të plotë nga juria profesioniste për secilën kategori të çmimit.

Tashmë është kthyer në traditë të konsoliduar "Çmimi AIITC", i organizuar çdo vit nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, i cili ka në fokus krijimtarinë e vitit që lëmë pas. Elementi kronologjik sipas viteve, bën edhe ndarjen midis krijimtarisë që merret në gjykim, ndërsa distanca kohore e ceremonisë bëhet me qëllim të shkëputjes emocionale dhe gjykimit objektiv nga ana e jurisë përzgjedhëse.

Për fituesin e vendit të parë në kategorinë "Libri më i mirë i vitit në gjuhën shqipe, që trajton tema në fushën e shkencës, artit dhe kulturës islame" u akorduan 3000 dollarë, për kategorinë e pikturës u dha shpërblimi prej 1500 dollarësh dhe për krijimtarinë e moshave të reja në prozë dhe poezi u akorduan 500 dollarë.



Organizatori dhe drejtori i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, Dr. Ramiz Zekaj, në fjalën e tij përshëndetëse, në fillim të aktivitetit, theksoi se qëllimi kryesor i këtij evenimenti është stimulimi i krijuesve të talentuar për të qenë më shumë të motivuar në punën e tyre dhe që shkenca e arti shqiptarë të prekë majat më të larta të suksesit, e të renditet përkrah vendeve të tjera evropiane. Gjithashtu, ai shtoi se mungesa e një kritike aktive dhe të konsoliduar në trojet shqiptare, e bën shumë të nevojshëm mbajtjen e këtij evenimenti, në të cilin testohen prurjet artistiko-shkencore të vitit dhe krijohet një orientim i qartë drejt vlerave të mirëfillta dhe mesazheve të dobishme për shoqërinë shqiptare, që ka kaluar shumë peripeci e sfida.

> **Tashmë është kthyer në traditë të konsoliduar "Çmimi AIITC", i organizuar çdo vit nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, i cili ka në fokus krijimtarinë e vitit që lëmë pas. Personalitete të shkencës dhe artit shqiptar morën medalje argjendi, dëshmi motivuese dhe stimuj në vlerë monetare për arritjet e tyre.**

Sipas Z. Zekaj në këtë edicion të tretë të "Çmimit AIITC", numri i konkurrentëve është rritur ndjeshëm, por në mënyrë të dukshme është rritur edhe niveli artistik e shkencor i krijimtarisë së paraqitur, gjë e cila e bën më të bukur, por njëherësh edhe më të vështirë dhënien e "Çmimit AIITC".

Dr. Ramiz Zekaj falënderoi të gjithë krijuesit e talentuar shqiptarë që konkurruan me forcën, talentin dhe dinjitetin e tyre në "Çmimin AIITC 2008".

Më pas përshëndeti të pranishmit kryetari i jurisë për vlerësimin e librit më të mirë në fushën e shkencës, kulturës dhe artit islam, i cili komunikoi edhe emrat e fituesve. Libri më i mirë i vitit në fushën e shkencës dhe kulturës islame u vlerësua libri studimor me titull "Përkthimet e letërsisë arabe në gjuhën shqipe", i cili sjell për lexuesin shqiptar ajkën e krijimtarisë letrare arabe. Ky libër i hartuar me mjeshtëri nga profesori i orientalistikës në Universitetin e Prishtinës, Dr. Feti Mediu, sjell një këndvështrim shumë origjinal dhe fakte shkencore të panjohura më parë. Vlerësime në këtë kategori morën edhe librat "Vexhi Buharaja – pa mite e mjegull", i autorit Yzedin Hima, libri publicistiko-letrar "Myftinia e Dibrës dhe Ruzhdi Lata" i autorit Mevlud Buci, libri "Hafiz Ibrahim Dalliu (Jeta dhe Vepra)" i autorit Xhemal Balla, si dhe libri "Xhamitë e Tiranës" i autorit Roald Hysa.

Për herë të parë në historinë e kulturës shqiptare, akordohet një çmim i posaçëm për pikturat me tematikë "Peizazhi në penelat e piktorëve shqiptarë", ku këtë vit me çmimin e parë u vlerësua piktori Idlir Koka. Çmimi iu dorëzua nga kryetari i jurisë së zhanrit të pikturës, Z. Ylli Drishti, i cili vlerësoi me nota pozitive të gjithë konkurrentët për krijimtarinë e tyre artistike në detajet e gjetura për paraqitjen e peizazhit.

Në kategorinë e tretë të çmimit, pikërisht të krijimeve nga moshat e reja, pjesë e konkurrimit ishin të rinj mjaft të talentuar, të cilët krijimet e tyre i kanë afirmuar më parë edhe në botime të veçanta. Në këto krijime spikaste thellësia e mendimit, shprehja e rafinuar poetike, figuracioni i gjerë dhe filozofia e habitshme për moshat e tyre si individualitete krijuese. Larmia e formave poetike vërvitej rreth një boshti të vetëm, pikërisht rreth të bukurës në shpirt dhe në jetë, që ishte edhe tema kryesore e këtij konkurrimi.

Jo vetëm krijimtaria e botuar, por edhe dorëshkrimet e të rinjve të talentuar ishin epiqendër e "Çmimit AIITC", me qëllim të evidentimit të vlerave dhe mbështetjes së vazhdueshme për afirmimin e tyre, sepse shpesh Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam ka marrë përsipër edhe botimin e krijimeve të tyre. Kryetari i jurisë për krijimin më të mirë nga moshat e reja në prozë dhe në poezi, me temë "E bukura në shpirt dhe në jetë" ishte prof. dr. Arian Kadiu, i cili bëri të ditur edhe fituesit e kësaj kategorie. Kështu, me çmimin e parë u vlerësua studentja e Fakultetit Histori- Filologji, Aseda Behari, për romanin e saj " Një jetë tjetër", ndërsa me çmimin e dytë për lëvrimin e poezisë me thellësi filozofike u vlerësua Oltion Lila, student i Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë.

Çmime inkurajuese u dhanë edhe për të rinj të tjerë të talentuar si: Sytrim Halitaj nga Kosova për vëllimin e tij poetik "Vesa e përditshmërisë", për poezitë e studenteve të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Lindita Pima dhe Gentiana Zmalaj, si dhe për nxënësen e shkollës së mesme "Qemal Stafa" , Ejona Qesari.

Ceremonia e ndarjes së "Çmimeve AIITC" u finalizua me një koktej, në sfond të të cilit ishin të ekspozuara disa nga pikturat më të vlerësuara dhe librat më të mirë të autorëve konkurrues të edicionit të tretë të çmimit.

5 vjet “Sireta 2F sh.p.k.”

Reklamë

Edhe pak dit dhe kompania “Sireta 2F SHPK” feston pesë vjetorin e lindjes. Pesë vjet i thonë pak por aktiviteti i kësaj kompanie ka ardhur gjithmonë në rritje. E liçensuar në fushën e ndërtim-konstruksione, studim, projektim dhe zbatim të veprave ujësjellëse kanalizime, ndërtim dhe ristrukturim rrugësh, shkolla e kopshte. Sot tashmë kemi të bëjmë me një kompani serioze dhe me një staf të kompletuar e me një përvojë të gjatë pune. Kompania me qendër në Tiranë e administrator të vetme Fatime Palin e ka shtrirë gjeografinë e punimeve të saj në të gjithë Shqipërinë. Personeli administrativ i kësaj kompanie përbëhet nga menaxher biznesi, inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier elektrik, inxhinier mekanik, inxhinier mjedisi, ekonomistë e teknik të mesëm ndërtimi si dhe mjaft specialist të ndryshëm. Kompania disponon makineri të shumta për kryerjen e punimeve si kamiona fiat, kamiona benz, kamiona iveko, eskavator të ndryshëm, asfalto shtruese, grejder, rrul, gjenerator, motosaldatriçe, bota uji, betoniere, betoforma, skeleri metalike, etj. Ka të punësuar mbi 40 puntorë e specialist ku të gjithë janë të siguruar dhe kanë përfituar tashmë një përvojë të gjatë pune në këtë kompani. Shumica e të punësuarve janë nga Dibra pasi vetë administratorja është dibrane. Për periudhën 2005-2009 kompania “Sireta.2F SHPK” ka kryer këto vepra:

- **Bashkia Kavajë rrugë 1 km**
- **Bashkia Kamëz sistemimi i shesheve me ndriçim, me pllaka, gjelbërim**
- **Asfaltim rruge Shkozë**
- **Rikonstruksion i ndërtesës së Muzeut Historik Kombëtar**
- **Rikonstruksioni i qendrës kulturore të ushtrisë,**
- **Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Babru –Fushë, shkollë kjo me të gjitha parametrat bashkëkohorë**
- **Ndërtimi i sheshit të helikopterëve maja e Dajtit**
- **Ristrukturimi i antenës kryesore Dajt**
- **Rikonstruksioni - Ministrisë së Shëndetësisë**
- **Rikonstruksioni i auditorit të kirurgjisë.**

Të gjitha veprat e ndërtuara dhe rikonstruktuara nga kompania ‘Sireta 2F SHPK” janë të një cilësie të lartë pasi cilësia dhe korrektësia në punë ka bërë që kjo kompani të konkurojë bindshëm në fushën e ndërtimeve në vendin tonë. Po mbushën pesë vjet, pesë vjet që është liçensuar dhe kur bën sot analizën e objekteve të ndërtuara dhe ristrukturuara ato vërtet janë të shumta. Kështu si e ka nisur nesër kur të festojë dhjetë vjetorin “Sireta 2F SHPK” do të flas me gjuhën e shifrave, do të jetë krenare për atë që ka realizuar në dhjetë vjet do ta ketë zgjeruar edhe më shumë gjeografinë e shpërndarjes së punimeve të kryera..







Adresa: Komuna Paskuqan Tiranë.
Tel: 069 20 44 111; 069 20 59 333
E-mail: sireta2fshpk@hotmail.com